EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5698
E shtunë, 9 shkurt 2019
çmimi 0.40 €

Zgjedhjet presidenciale në Maqedoninë Veriore, më 21 prill

FAQE 2

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

PRESIDENTI I VENDIT, HASHIM THAÇI, PAS KTHIMIT NGA SHBA-ja KA MBAJTUR KONFERENCË PËR MEDIE

THAÇI: KËSHILLA E SHBA-së PËR PEZULLIM TË TAKSËS TË RESPEKTOHET

Pas kthimit nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA), presidenti Hashim Thaçi ka ftuar Qeverinë që ta respektojë këshillën e ShBA-së për ta pezulluar taksën ndaj mallrave nga Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina. Ai ka thënë të premten se ka marrë porosi të qartë në Uashington se pa pezullimin e taksës nuk mund të vazhdojë dialogu në Bruksel. Thaçi ka theksuar se Kosova duhet të vazhdojë të investojë fuqishëm për t'i ruajtur dhe kultivuar raportet me ShBA-në. Sipas tij, nuk ka çmim që mund ta paguajë ndonjë devijim apo dobësim të raporteve në mes të shtetit të Kosovës dhe ShBA-së

Haradinaj, Vuçiqit: Do ta mbrojmë sovranitetin dhe integritetin e Kosovës

FAQE 3

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë se deklarimet e presidentit serb për mosnjohje të kufijve janë të papranueshme dhe paraqesin cenim serioz të sovranitetit dhe integritetit territorial të Kosovës. Sipas Haradinajt, këto deklarime janë sulme të hapura ndaj sovranitetit dhe integritetit territorial të Kosovës si dhe rrezikojnë paqen, stabilitetin dhe sigurinë në Kosovë dhe në rajon

Shkaku i plaçkitjeve institucionet shtojnë sigurinë

FAQE 9

AKTUALE

ASKUSH NUK MUND T'I BËJË GJYQ UÇK-së F. 11

Prof. Lisen BASHKURTI

KIRURGËT TË PËRÇARË, DISA NË GREVË E DISA NË PUNË F. 5

PROTESTOHET NË DRENAS PAS RASTIT TË ABUZIMIT ME TË MITURËN F. 7

EKONOMI

FMN-ja E SHQETËSUAR ME LIGJIN PËR PAGAT, VITI 2020 PROBLEMATIK F. 9

KOSOVA DHE MAQEDONIA E VERIUT, MARRËVESHJE NË FUSHËN E AUDITIMIT F. 9

KULTURË

LIBRI "LAMTUMIRË BACA ADEM" PASQYRON DHIMBJEN DHE KRENARINË E LIGJSHME PËR NDERIN E KOMBIT, ADEM DEMAÇIN F. 5



Ibish NEZIRI

SPORT

FERIZAJ DHE FERONIKELI NË KËRKIM TË GJYSMËFINALES F. 18

RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht – Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · ÇUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Ruçi: Shqipëria do ta ratifikojë Protokollin e Maqedonisë në NATO

Tiranë, 8 shkurt - Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, Gramoz Ruçi, priti të premten të ngarkuarin me punë të Maqedonisë Veriore në Tiranë, Dancho Markovski. Në fokus të bisedës ishin zhvillimet më të fundit në Maqedoni, nënshkrimi nga vendet anëtare të NATO-s të protokollit të anëtarësimit të Maqedonisë së Veriut në aleancën më të madhe ushtarake të globit.

Kryetari i Kuvendit përgëzoi Markovskin për arritjen historike e të shumëpritur, e cila është përshëndetur nga të gjitha institucionet shqiptare dhe që është një lajm i mirë jo vetëm për Maqedoninë, por edhe për të gjithë rajonin. "Maqedonia në NATO është mirëpritur nga të gjitha institucionet shqiptare, si suksesi i një vendi fqinj, me të cilin gjendemi gjeografikisht në të njëjtin rajon, por me të cilin ndajmë vizionet e së ardhmes së përbashkët euro-atlantike", u shpreh Ruçi.

Markovski i shprehu falënderimet dhe mirënjohjen kryetarit të Kuvendit për mbështetjen e vazhdueshme të Kuvendit të Shqipërisë dhe Republikës së Shqipërisë ndaj vendit të tij. Duke cilësuar se këto zhvillime i dhanë fund një periudhe pritjeje prej 20 vjetësh, përcolli synimin e autoriteteve maqedonase që të arrijnë ratifikimin e Protokollit për anëtarësim në NATO brenda një periudhe prej 12-mujore.

Kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi, u shpreh se gjatë vizitës së tij në Shkup në dhjetor 2018, në takimet me autoritetet më të larta, kishte marrë angazhimin që Shqipëria do të ishte ndër vendet e para që do ratifikonte këtë Protokoll dhe se tashmë

Qeveria shqiptare e kishte miratuar vendimin, i cili ka arritur në Kuvend dhe do të ratifikohet me procedurë të përshpejtuar. "Data e parë e mundshme për këtë ratifikim është seanca e javës së ardhshme, 14 shkurt 2019", tha Ruçi.

Zgjedhjet presidenciale në Maqedoninë Veriore mbahen më 21 prill

Kryetari i Kuvendit të Maqedonisë Veriore, Talat Xhaferi, të premten ka shpallur zgjedhjet presidenciale ku, sipas Kushtetutës dhe afateve të parapara, raundi i parë i zgjedhjeve presidenciale do të mbahet më 21 prill, ndërsa i dyti më 5 maj. Kandidatët duhet të paraqiten deri më 21 mars, ndërsa fushata zgjedhore do të fillojë më 31 mars

Shkup, 8 shkurt - Kryetari i Kuvendit të Maqednisë Veriore, Talat Xhaferi, të premten ka shpallur zgjedhjet presidenciale në këtë shtet. Sipas Kushtetutës dhe afateve të parapara, raundi i parë i zgjedhjeve presidenciale do të mbahet më 21 prill, ndërsa i dyti më 5 maj.

Kandidatët duhet të paraqiten deri më 21 mars, ndërsa fushata zgjedhore do të fillojë më 31 mars.

Qeveria dhe opozita vazhdojnë të taktizojnë me kandidatët për president.

Kryeministri Zoran Zaev së fundi ka deklaruar se mbështet idenë për kandidat të përbashkët.

Kongresi i LSDM-së është caktuar për 3 mars, ndërsa në garë për kandidat partiak mbeten katër emrat për të cilët aktualisht janë duke u zhvilluar anketa të brendshme, Oliver Spasovski, Stevo

Pendarovski, Nikolla Dimitrov dhe Radmilla Shekerinska.

Në rast se shumica parlamentare nuk arrin marrëveshje për kandidat të përbashkët, LSDM-ja do të garojë me kandidat partiak i cili do të mbështetet edhe nga PDSh-ja.

Bashkimi Demokratik për Integrim do të garojë i vetëm, kurse Besa e Bilall Kasamit insiston në kandidat të përbashkët me Aleancën për Shqiptarët, ndërsa Besa e Afrim Gashit ende shqyrton modalitetet.

VMRO-ja opozitare para disa ditëve publikoi emrat e kandidatëve për president, e në listë janë këta emra: Nikita Shektukovski, Gjorgi Manaskov, Vasko Kostov, Vllatko Gjorçev, Gordana Siljanovska-Davçeva, Filip Petrovski, Ilija dimovski, Goran Angellov dhe Sasho Kutlleshoski. Nëntë kandidatët e paraqitur në konkursin e VMRO-DPMNE-së për president kanë filluar promovimin e programeve të tyre para qytetarëve.

Parlamenti grek voton ratifikimin e Protokollit për anëtarësimin e Shkupit në NATO

Athinë, 8 shkurt - Pasi mori dritën jeshile nga Komisioni kompetent, projektligji për ratifikimin e Protokollit për anëtarësim në NATO, do të sillet në mbledhjen plenare të Parlamentit grek, ndërsa debati do të përfundojë me votimin e deputetëve. "Ratifikimi i Protokollit të Marrëveshjes për përfshirjen e Republikës së Maqedonisë së Veriut në strukturat e NATO-s është pranuar në tërësi nga shumica", theksoi kryetari i Komisionit për Sigurinë Kombëtare, Konstantinos Duzinas, në fund të debatit i cili zgjati pesë orë e gjysmë.

Pas përfundimit të takimit, Duzinas parashtroi në parlament një raport në të cilin propozon të pranohet projektligji konkret, duke marrë parasysh qëndrimet e shumicës së anëtarëve të komisionit. Projektligji u pranua edhe nga deputetët e SYRIZA-s, si dhe deputetë të pavarur, ndërsa të gjitha partitë e tjera opozitare ishin kundër.

Që të votohet Protokolli për anëtarësimin në NATO, nevojiten minimum prej 151 votash nga ana e Parlamentit grek.

Protesta, qytetarët i "blejnë" Ramës biletë avioni me "Air Albania"

Tiranë, 8 shkurt - Qytetarët e Paskuqanit dhe qytetarët e Vlorës të premten pasdite kanë dalë në protestë kundër qeverisë. Të mbështetur nga Partia Demokratike, ata kanë çelur dy vatra të reja proteste ku kanë bllokuar dhe qarkullimin e mjeteve.

Protestuesit e Paskuqanit kanë bllokuar rrugën e vetme hyrëse në Paskuqan, në shenjë proteste kundër qeverisë. Në të njëjtën kohë dhe në Vlorë qytetarë të shumtë janë ngritur në protestë, duke bllokuar rrugën në zonën e quajtur Skelë. Duke ironizuar edhe kompaninë më të re ajrore "Air Albania", ata i kanë bërë edhe një dhuratë kryeministrit Edi Rama, një biletë vetëm vajtje.

Ndërsa Lulzim Basha, në kuadër të turit të takimeve me qytetarët për protestën e 16 shkurtit, të premten ishte në qytetin e Kukësit.

Basha u premtoi qytetarëve që do ta heqë taksën e "Rrugës së Kombit", por veç kësaj do hapë edhe Universitetin e Kukësit. Ai u bëri thirrje kuksianëve që më 16 shkurt të vijnë në Tiranë për t'i kërkuar të drejtat e tyre dhe rrëzimin e qeverisë së krimit. "Gjëja e parë që do të zotohem para jush, çdo padrejtësi që ka bërë Rama ndaj kuksianëve, do ta bëjmë që në javët e para në pushtet, duke nisur me anulimin e traut. Taksa do zerohet. Ju e arritët një sukses, treguat rrugën si komunikohet me Ramën", deklaroi Basha.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Qeveria e Republikës së Kosovës ka reaguar ndaj deklaratave të presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiqit, për kufijtë

Haradinaj, Vuçiqit: Do ta mbrojmë sovranitetin dhe integritetin e Kosovës

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë se deklarimet e presidentit serb për mosnjohje të kufijve janë të papranueshme dhe paraqesin cenim serioz të sovranitetit dhe integritetit territorial të Kosovës. Sipas Haradinajt, këto deklarime janë sulme të hapura ndaj sovranitetit dhe integritetit territorial të Kosovës si dhe rrezikojnë paqen, stabilitetin dhe sigurinë në Kosovë dhe rajon. Kryeministri Haradinaj është zotuar se do ta mbrojë sovranitetin dhe integritetin territorial të Kosovës në përputhje me Deklaratën e Pavarësisë së 17 shkurtit 2008 dhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës

EPOKA E RE **Shqipe HETEMI**

Prishtinë, 8 shkurt - Qeveria e Republikës së Kosovës të premten ka reaguar ndaj deklaratave të presidentit serb për mosnjohje të kufijve të shtetit të Kosovës. Me këtë rast, kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se deklaratat kërcënuese, agresive dhe luftënxitëse të presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, të dhëna se nuk i njeh kufijtë e Kosovës, kufijtë ndërkombëtarisht të njohur dhe të pranuar, në Jarinjë dhe Bërnjak, janë të papranueshme dhe paraqesin cenim serioz të sovranitetit dhe integritetit territorial të Kosovës. Ai ka thënë se këto deklarime janë sulme të hapura ndaj sovranitetit dhe integritetit territorial të Kosovës si dhe rrezikojnë paqen, stabilitetin dhe sigurinë në Kosovë, rajon dhe më gjerë. "Deklaratat e fundit kërcënuese, agresive dhe luftënxitëse të presidentit të Serbisë, Aleksander Vuçiq, të dhëna më 7 shkurt 2019 në qytetin e Vranjës në Serbi, se nuk i njeh kufijtë e Kosovës, kufijtë ndërkombëtarisht të njohur dhe të pranuar në Jarinjë dhe Bërnjak, janë të papranueshme dhe paraqesin cenim serioz të sovranitetit dhe integritetit territorial të Kosovës. Këto deklarime janë edhe sulme të hapura ndaj sovranitetit dhe integritetit territorial të Kosovës si dhe rrezikojnë paqen, stabilitetin dhe sigurinë në Kosovë, rajon dhe më gjerë", ka deklaruar Haradinaj.

Kryeministri Haradinaj është zotuar se do ta mbrojë sovranitetin dhe integritetin territorial të Kosovës në përputhje me Deklaratën e Pavarësisë së 17 shkurtit 2008 dhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. "Si kryeministër i Republikës së Kosovës zotohem se do të ndërmarr të gjitha veprimet kushtetuese dhe ligjore me qëllim të ruajtjes së sovranitetit dhe integritetit territorial të Kosovës në përputhje me Deklaratën e Pavarësisë së 17 shkurtit 2008 dhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Një ditë më parë presidenti i Serbisë, Aleksander Vuçiq, ka thënë se nuk i njeh kufijtë e Kosovës së pavarur ashtu siç i kanë njohur paraardhësit e tij dhe, sipas tij, këtu është edhe dallimi. "Po, nuk i njoh kufijtë e një shteti të pavarur të Kosovës, siç bënë të tjerët dhe ne ndryshojmë në përputhje me rrethanat. Këto janë politika të ndryshme, por politika jonë nuk është politikë e pafajësisë dhe papërgjegjshmërisë", ka theksuar ai. Megjithatë, presidenti serb ka thënë se nevojitet paqe me shqiptarët e Kosovës dhe beson se është i mundshëm një kompromis, pasi nuk ka nevojë për konflikte në të ardhmen. "Neve na duhet paqja me shqiptarët dhe unë nuk mendoj se është i mundshëm kompromis i shpejtë. Nuk jam fare optimist se ai do të arrihet, por ne duhet të insistojmë sepse nuk na duhen kurrfarë konfliktesh në të ardhmen", ka deklaruar Vuçiqi.

Shkodra: Të gjithë atë që do të bëjnë shkelje do të përballen me ligjin

Prishtinë, 8 shkurt (ER) - Në Ministrinë e Punëve të Brendshme është mbajtur të premten takimi i autoritetit qeveritar për Strategjinë Shtetërore kundër Krimit të Organizuar dhe Planin e Veprimit 2018-2022. Takimin e hapi koordinatori nacional Kundër Krimit të organizuar, njëherësh zëvendësministër i Punëve të Brendshme, Selami Shkodra. Të gjithë aktorët u njoftuan me strategjinë e re e cila është miratuar në Qeverinë e Kosovës.

Strategjia për periudhën 2018-2022 është vazhdimësi e strategjisë paraprake dhe në të janë të përfshirë aktivitete që do të ndihmojnë në luftimin e krimit të organizuar.

Fillimisht zëvendësministri Shkodra ka prezantuar para autoritetit Strategjinë Shtetërore dhe Planin e Veprimit kundër Krimit të Organizuar 2018-2022. Ai ka kërkuar angazhim të gjithë aktorëve në mënyrë që të implementohen aktivitetet e parapara në këtë strategji. "Përkundër përpjekjeve të vazhdueshme që po bën Policia e Kosovës për luftimin e krimit të organizuar, kërkoj angazhim shtesë duke marrë për bazë rastet e fundit të shtimit të veprave penale. Kam besim të plotë se Policia e Kosovës është e aftë dhe do t'i menaxhojë edhe këto raste me sukses", ka thënë zëvendësministri Shkodra. Ai është zotuar se do të bëhen përpjekje maksimale për luftimin e të gjitha llojeve të krimit në Kosovë, duke theksuar se të gjithë atë që do të bëjnë shkelje do të përballen me ligjin.

Ministria e Punëve të Brendshme është bartëse kryesore e strategjive të mëparshme dhe nën udhëheqjen e saj ka hartuar Strategjinë dhe Planin e Veprimit kundër Krimit të Organizuar 2018-2022.

Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, pas kthimit nga ShBA-ja ka mbajtur konferencë për medie

Thaçi: Këshilla e ShBA-së pezullim të taksës të res

Pas kthimit nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA), presidenti Hashim Thaçi ka ftuar Qeverinë ta respektojë këshillën e ShBA-së për ta pezulluar taksën ndaj mallrave nga Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina. Ai ka thënë të premten se ka marrë porosi të qartë në Uashington se pa pezullimin e taksës nuk mund të vazhdojë dialogu në Bruksel. Thaçi ka theksuar se Kosova duhet të vazhdojë të investojë fuqishëm për të ruajtur dhe kultivuar raportet me ShBA-në. Sipas tij, nuk ka çmim që mund ta paguajë ndonjë devijim apo dobësim të raporteve në mes të shtetit të Kosovës dhe ShBA-së

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 8 SHKURT - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, edhe një herë ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës që ta respektojë kërkesën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) për pezullim të taksës, për t'i dhënë mundësi procesit të dialogut.

Në një konferencë për medie, pas kthimit nga ShBA-ja, ku mori pjesë në Lutjet e Mëngjesit, ai ka thënë se çdo institucion i Kosovës e ka për obligim që t'i kultivojë raportet strategjike me ShBA-në. "Ne duhet të vazhdojmë të investojmë fuqishëm për të ruajtur dhe kultivuar partneritetin strategjik me kontribuuesit e jashtëzakonshëm të pavarësisë dhe tani të themelimit të ushtrisë, me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Veç një kultivim dhe ushqim i raporteve nga shteti i Kosovës garanton konsolidim të shtetit tonë, progres, zhvillim ekonomik dhe të ardhme të sigurt euroatlantike. Pra, anëtarësim në NATO dhe BE dhe, në një të ardhme jo të largët, edhe anëtarësim në OKB", ka thënë Thaçi.

Shefi i shtetit ka deklaruar se porosia e presidentit dhe zyrtarëve të lartë amerikanë është se Kosova duhet të jetë e përgjegjshme në veprimet e veta shtetërore. "Kosova duhet të jetë e përgjegjshme në angazhimet e veta shtetërore, ta ruaj partneritetin me gjithë shtetet që e kanë ndihmuar dhe kanë qëndruar me popullin dhe shtetin e Kosovës afër në çdo rrethanë, e ato janë ShBA-ja, vendet e BE-së dhe shtetet anëtare të NATO-s, shtete këto që kanë investuar shumë", është shprehur Thaçi, duke shtuar se Kosova duhet t'i tejkalojë vështirësitë dhe ta pezullojë taksën. "Prandaj, edhe thirrjet e zyrtarëve të ShBA-së për institucionet e vendit janë që Kosova ta tejkalojë këtë percepcion aktualisht të krijuar si pengesë e angazhimeve për dialog e negociata dhe mundësinë e arritjes së një marrëveshje paqësore në mes shtetit të Kosovës dhe Serbisë, që Kosova t'i tejkalojë vështirësitë që po paraqiten në këtë proces, në veçanti, jo tërheqjen, por pezullimin e taksës në mënyrë që të vazhdojë dialogu", ka thënë Thaçi.

I pari i vendit ka treguar se gjatë qëndrimit në ShBA ka kërkuar që askush nga palët të mos e kushtëzojë procesin e dialogut. "Edhe unë kam potencuar qartë se dialogut duhet të zhvillohet i pakushtëzuar, duke mos ofruar vështirësi e pengesa nga askush, në të njëjtën kohë të mos jetë i

për pektohet

kushtëzuar as nga Serbia. Prandaj, mendoj se kjo këshillë definitivisht nga institucionet e vendit duhet të respektohet. E ritheksoj jo heqjen, por pezullimin, për t'i dhënë mundësi procesit të dialogut", është shprehur ai.

Presidenti Thaçi ka deklaruar se është krijuar percepcioni se me vendosjen e taksës 100 për qind ndaj importeve nga Serbia dhe Bosnja, Kosova është bërë pengesë për procesin e dialogut që ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian. Sipas presidentit, është në dorën e Qeverisë që ta pezullojë këtë masë. "Natyrisht se ky vendim i takon Qeverisë së Kosovës dhe partnerëve të koalicionit, por theksoj se në shikim të parë duket se Serbia po dëmtohet në rrafshin ekonomik për disa dhjetëra milionë euro, por nuk ka çmim që mund ta paguajë ndonjë devijim apo dobësim të raporteve në mes të shtetit të Kosovës dhe ShBA-së. Mbi çdo çmim është ruajtja e këtij relacioni për të ecur përpara. Prandaj, ftoj spektrin politik të mendojë në mënyrë racionale, të mendojë në mënyrë të urtë dhe në rrafshin strategjik", ka thënë Thaçi.

Ai ka komentuar edhe idenë e kryeministrit, Ramush Haradinaj, për organizimin e një konference ndërkombëtare për Kosovën, duke thënë se kjo gjë do të ishte hap mbrapa. "Ajo që fuqishëm e theksoj, është kjo: nuk duhet që të lejohet të kërkohet organizimi i një konference ndërkombëtare për Kosovën, pasi kjo është një kthim mbrapa dhe përfshin faktorin rus në këtë proces, që për neve do të ishte shumë e disfavorshme. Duhet të eliminojmë në çdo rrethanë që në asnjë forum të mos diskutohet asociacioni me elemente ekzekutiv sepse paraqet definitivisht krijimin e një Republika Serpska në Kosovë dhe e defunksionalizon shtetin e Kosovës", ka thënë Thaçi.

Sa i përket deklaratës së tij, se nëse një korrigjim i lehtë i kufirit është çmimi për marrëveshje përfundimtare të paqes, presidenti ka thënë se zyrtarizmi i kufijve duhet të ndodhë që të ketë njohje. "Ne kemi bërë zyrtarizmin e kufirit në mes të Kosovës dhe Maqedonisë. Diçka e tillë ka ndodhur edhe me Malin e Zi. E njëjta procedurë duhet të ndodhë edhe me shtetin serb. Prandaj, kufijtë e Kosovës me Serbinë janë edhe në veri edhe në jug që duhet të zyrtarizohet për të ndodhë njohja", ka deklaruar ai.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Evropian i kanë kërkuar Prishtinës zyrtare që ta pezullojë taksën doganore e cila është në fuqi që prej nëntorit të vitit të kaluar. Në një deklaratë të Ambasadës Amerikane në Prishtinë, të publikuar javë më parë, është thënë se janë kundër supozimit se "Kosova apo cilido mik tjetër i Shteteve të Bashkuara mund të ndërmarrë veprime që janë kundër interesave tona strategjike, pa u ballafaquar me pasojat për marrëdhënien tonë bilaterale", është thënë në deklaratë.

Me idenë për pezullimin e taksës në një afat prej 120 ditëve ka dalë edhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli. Por, kryeministri Ramush Haradinaj po insiston se taksa doganore do të mbetet në fuqi deri në njohjen e Kosovës nga Serbia.

Kirurgët të përçarë, disa në grevë e disa në punë

Prishtinë, 8 shkurt - Jo të gjithë kirurgët janë duke e vazhduar grevën, e cila kishte nisur qysh në fund të dhjetorit të vitit të kaluar. Ata tashmë janë ndarë në dysh. Një pjesë e kirurgëve e kanë braktisur grevën, ndërsa një pjesë tjetër vazhdon të insistojë për koeficientin tetë me Ligjin e ri për pagat. Mjekët specialistë me këtë ligj janë radhitur në koeficientin e pestë.

Përfaqësuesi i grevistëve, Arbër Morina, në vazhdimësi ka kërkuar koeficientin tetë e që ua mundëson atyre një pagë prej 1 912 eurosh. Aktualisht, mjekët specialistë pagën mujore e kanë rreth 600 euro, por pas hyrjes në fuqi të Ligjit për paga, ata do të kenë rritje.

Në Ministrinë e Shëndetësisë thonë se mjeku specialist tashmë është radhitur në koeficientin pesë, që nënkupton se ata do të kenë pagë prej 1 195 eurosh.

Albatrit Matoshi, këshilltar për media i ministrit të Shëndetësisë, Uran Ismaili, i ka thënë "Radios Evropa e Lirë", se pas miratimit të Ligjit për paga, është mundësuar një dyfishim i pagave dhe, sipas tij, kjo paraqet rritjen më të madhe në 20 vjetët e fundit për profesionistët shëndetësorë. "Kemi pasur një reflektim edhe te kirurgët. Kemi ndërprerje të grevës së kirurgëve torakalë, të urologjisë, të cilët janë më aktivë në dialogun social me Ministrinë e Shëndetësisë. Me këta të fundit e kemi pasur edhe sot një bisedë që të gjendet një zgjidhje për ta dhe t'u kthehen sallave të operacionit me kapacitet të plotë, meqë pagat e tyre tashmë janë rritur. Jemi duke punuar për t'i përmirësuar kushtet e punës për ta dhe besoj se edhe kirurgët që kanë qenë në grevë t'i kthehen punës me kapacitet të plotë", ka thënë Matoshi. Ai ka thënë se pacientët duhet të kenë trajtime dinjitoze dhe të mos mjekohen jashtë institucioneve publike shëndetësore. "Disa kirurgë janë ende në grevë, por jo të gjithë siç kanë qenë deri tash", ka thënë Matoshi.

Ndërsa Arbër Morina, kirurg, ka deklaruar se greva po vazhdon. Sipas tij, ajo nuk do të ndërpritet deri në rishqyrtimin e Ligjit për paga, për faktin se me ligjin e fundit të miratuar në Kuvend, siç tha ai, është konstatuar shkelje procedurale dhe shkelje ligjore. Morina ka shtuar se për këtë arsye, në procedura dhe në përmbajtje ka shkelje të rënda, të cilat janë ndesh me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe mendojnë se ky ligj duhet të rishikohet dhe të riformulohet. "Kërkesa jonë do të jetë e njëjta, rregullimi i koeficientit, i cili do ta pasqyrojë dinjitetin e mjekut në Republikën e Kosovës. Kërkesa jonë është shumë reale, sepse kërkesa jonë bazohet në ligj. Tash, a do të kemi përkrahje apo jo, varet se kush do të na ofrohet për përkrahje. Deri më tash nuk kemi pasur përkrahje për shkak se gjithçka është bërë jashtë ligjit. Ne po presim përkrahje", ka thënë Morina për "Radion Evropa e Lirë".

Ndërsa Sami Deliu, kirurg ortoped, ka bërë me dije se, ndonëse janë të pakënaqur me koeficientin në Ligjin e ri për paga, kanë vendosur që grevën ta ndërpresin dhe të punojnë me kapacitet të plotë. "Ne jemi të pakënaqur me Ligjin e ri për paga, por kemi vendosur, për hir të pacientëve dhe procesit, ta vazhdojmë punën edhe me rastet e ftohta, pra me ambulancat specialistike. Ndryshe, edhe gjatë grevës rastet emergjente janë kryer dhe operacionet janë bërë për shkak të natyrës emergjente të punës që e kemi", ka thënë Deliu.

Aktualisht greva është ndërprerë edhe nga kirurgët e spitaleve rajonale, si dhe nga Kirurgjia Torakale dhe Klinika e Ortopedisë. Ndërkaq, në të gjitha klinikat e tjera kirurgjike, sipas doktorit Arbër Morina, greva është duke vazhduar.

Arrestohet i dyshuari ndaj të cilit vite më parë është lëshuar letër-rreshtim ndërkombëtar

Prishtinë, 8 shkurt (ER) - Policia e Kosovës, në frymën e bashkëpunimit ndërkombëtar, në këtë rast pas shkëmbimit të informacioneve dhe bashkëpunimit të ndërsjellë të ILECU-t me autoritetet e disa shteteve, ka arritur ta identifikojë dhe të lokalizojë vendin ku qëndronte i dyshuari B. M., lindur më 1982, mashkull/shtetas i Kosovës, ndaj të cilit ishte lëshuar letër-rreshtimi ndërkombëtar. "I dyshuari B. M. ishte në kërkim nga autoritetet vendore që nga viti 2007, pasi i njëjti dyshohej se ishte i përfshirë vite më herët në rastin penal 'ndihmesë në vrasje të rëndë' dhe që nga viti 2006 ishte dënuar me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë, me 4 (katër) vjet burgim, duke llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim në vitin 2004", është thënë në njoftimin e Policisë së Kosovës.

Ndërsa në vitin 2007 Gjykata Supreme e Kosovës me aktgjykim ka rritur dënimin nga katër vjet, në dymbëdhjetë vjet burgim dhe me aktvendim ka urdhëruar që i akuzuari të dërgohet në mbajtje të dënimit, mirëpo aktvendimi nuk ka arritur të ekzekutohet, pasi i njëjti dyshohej se ka qenë jashtë vendit. "Meqë personi i dyshuar dyshohej se ishte jashtë vendit, kanë vazhduar procedurat e shpalljes së letër-rreshtimit ndërkombëtar dhe që nga ajo kohë i dyshuari ka qenë në kërkim ndërkombëtar. Policia e Kosovës, përmes Drejtorisë për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Fushën e Zbatimit të Ligjit (ILECU-t) dhe njësisë FAST Kosova, në disa shtete të ndryshme të rajonit dhe Evropës kanë bërë kërkimin e personit të dyshuar si dhe kanë verifikuar e shkëmbyer informacione me interes të përbashkët, me qëllim të identifikimit dhe arrestimit të personit të dyshuar", është thënë në njoftimin për media.

Në nëntor të vitit 2018 Policia e Kosovës ka pranuar informacion se i dyshuari ndodhej duke punuar në Gjermani, por me identitet të falsifikuar shqiptar dhe për këtë janë kryer verifikimet në dy shtete, në Gjermani dhe në Shqipëri. "Informacionet dhe verifikimet zyrtare kanë rezultuar të drejta dhe FAST Gjermania kishte filluar të merrej me rastin, i cili ka rezultuar me arrestimin e tij më 7 shkurt 2019. Policia e Kosovës përmes institucioneve relevante ka filluar procedurat e ekstradimit të personit të dyshuar. Policia e Kosovës mbetet e përkushtuar për realizimin e detyrave dhe përgjegjësive ligjore me qëllim të parandalimit të krimit, arrestimit të kryerësve të veprave penale si dhe krijimit të një ambienti sa më të qetë dhe të sigurt për qytetarët", është bërë me dije në komunikatën e Policisë së Kosovës.

Reka: Tri vendimet sovrane të Kosovës dridhen tri shtyllat e dialogut të Brukselit

Prishtinë, 8 shkurt (ER) - Profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, Blerim Reka, ka thënë se për vetëm tre muaj tri vendime sovrane të shtetit të Kosovës dridhen tri shtyllat e dialogut të Brukselit. "Taksa, Ushtria dhe 'Trepça' kontestuan virtualitetin, neutralitetin dhe asimetrinë e këtij dialogu. Bazuar në preambulën virtuale të kushtetutës serbe, BE-ja mbajti qëndrim neutral statusor ndaj Kosovës ('fusnota') dhe inauguroi negociata asimetrike midis dy palëve të pabarabarta. Serbisë, me kushtetutë të skaduar, që prodhoi blofin për 'negociatat me krahinën'; dhe Kosovës, e cila po përsërit se janë të panegociueshme territori, sovraniteti dhe pasuritë e saj natyrore", ka thënë Reka përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook". Ai ka theksuar se për zhbllokim të dialogut Kosova edhe mund ta pezullonte përkohësisht taksën, me kusht që Serbia ta ndryshojë preambulën e vet kushtetuese. "Maqedonia ndryshoi kushtetutën dhe emrin për të hyrë në NATO dhe BE. Serbia, nëse jo tash (pse e kërkon Kosova), do të detyrohet ta ndryshojë Kushtetutën e vet, pse këtë do ta kërkojë me vonë Brukseli (kapitulli 35). BE-ja nuk anëtarëson shtete me territor të padefinuar. Prandaj, Serbisë i ngutet që 'marrëveshja finale' t'i finalizojë edhe kufijtë", ka thënë profesori Reka.

Limaj takon ambasadorin britanik, flasin për dialogun Kosovë - Serbi

Prishtinë, 8 shkurt (ER) - Zëvendëskryeministri i Kosovës, Fatmir Limaj, njëherësh bashkëdrejtues i Delegacionit Shtetëror për Bisedime me Serbinë, ka pritur të premten në takim ambasadorin e Britanisë së Madhe në Kosovë, Ruairi O'Connell. Ata biseduan për proceset nëpër të cilat po kalon vendi.

Limaj e njoftoi ambasadorin për punën e delegacionit si dhe për përgatitjen e platformës për bisedime me Serbinë. "Ishte pajtim i përbashkët se është shumë e rëndësishme që Kosova të flasë me një zë në këtë proces dhe platforma ta paraqesë zërin unik të Kosovës dhe ta reflektojë vizionin dhe pozicionin zyrtar të vendit në bisedimet me Serbinë", ka thënë Limaj. Ai e ka falënderuar ambasadorin O'Connell për ndihmën e vazhdueshme që Britania e Madhe po jep për Kosovën.

Protestohet në Drenas pas rastit të abuzimit me të miturën

Qytetarë, përfaqësues të pushtetit lokal dhe nxënës kanë protestuar të premten në Drenas pas protestës që është mbajtur të enjten në Prishtinë në lidhje me rastin e abuzimit seksual të 16-vjeçares nga ky qytet. Po për këtë rast të premten është mbajtur edhe një seancë e jashtëzakonshme e Kuvendit të Kosovës

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

DRENAS, 8 SHKURT - Qindra qytetarë në Drenas, në mesin e tyre edhe nxënës, protestuan të premten, duke kërkuar drejtësi lidhur me rastin e raportuar të abuzimit seksual të një vajze të kësaj komune. Protestuesit mbanin në duar parulla "Pro mësimit, jo përdhunimit", "Kush me na mbrojt prej policisë" dhe "Pagat në rritje, siguria në ulje". Protestuesit bënë thirrje që rastet e abuzimeve seksuale të raportohen, duke kërkuar që personat e përfshirë në rastin e raportuar të ndiqen penalisht.

Pjesë e kësaj proteste ishte edhe kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, i cili ka thënë se sot ishte një ditë e rëndë për të gjithë. "Sot ishte një ditë e rëndë për të gjithë ne. Ishte ditë e manifestimit të zhgënjimit qytetar në Drenas ndaj rastit të abuzimit të vajzës së mitur nga njerëzit e tri profesioneve që gëzojnë besimin e secilit qytetar.

Së bashku me qytetarët e mi, me nxënësit, shpreha qëndrimin tim qytetar ndaj rastit të pashembullt në vendin tonë, ndaj abuzimit të së miturës, si një nga plagët më të rënda për një vajzë. Ishte ditë e rëndë sepse, rrugëve të komunës sonë, shprehëm solidaritet me vuajtjet e vajzës së abuzuar si dhe të familjes së saj. Ishte ditë e shprehjes së pakënaqësisë ndaj veprimeve të një arsimtari. Ishte ditë e shprehjes së pakënaqësisë ndaj veprimeve të një polici. Ishte ditë e shprehjes së pakënaqësisë ndaj veprimeve të një mjeku për të mos u përsëritur kurrë, askund", ka thënë Lladrovci.

Ai ka thënë se shpërdorimi i detyrës nga një individ nuk bën ta lëkundë besimin në arsim, polici, mjekësi e as prokurori. "Në këtë rast, presim sa më shpejt që organet gjegjëse të japin vendim për çfarëdo shkelje të detyrave apo përgjegjësive që bien ndesh me ligjin, nga të gjithë personat e implikuar në rastin e abuzimit", ka thënë kryetari Lladrovci.

Abuzimi seksual i vajzës nga Drenasi është thënë të ketë filluar kur ajo ka qenë 16-vjeçare, fillimisht nga profesori i saj. Pas denoncimit në polici nga viktima, hetuesi policor është thënë se ka abuzuar seksualisht me të dhe, në janar të këtij viti, e ka detyruar të kryejë abort të padëshiruar në një klinikë private në Prishtinë.

Autoritetet e rendit e kanë arrestuar zyrtarin policor dhe mësimdhënësin.

Një protestë për këtë rast është mbajtur të enjten edhe në Prishtinë, pranë Stacionit Qendër të Policisë së Kosovës.

Haradinaj takon drejtuesit e sektorit të sigurisë dhe arsimit, kërkon zbardhjen e rastit në Drenas

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka pritur të premten në takim drejtuesit e sektorit të sigurisë dhe arsimit me të cilët ka biseduar për rastin e 16-vjeçares nga Drenasi, e cila dyshohet se është abuzuar seksualisht nga një polic dhe një mësues. Ai ka bërë me dije se ka kërkuar që të ndërmerren të gjitha veprimet, bazuar në ligjet e Kosovës, për ta zbardhur të vërtetën dhe për t'i nxjerrë para drejtësisë të gjithë ata që kanë kryer vepër të jashtëligjshme në rastin e të miturës nga Drenasi. "Institucionet e vendit, prokuroria dhe gjykata, duhet ta dëshmojnë fuqinë e vet në zbatim të ligjit. Rasti i abuzimit seksual të të miturës nga Drenasi duhet të trajtohet në kohë dhe me profesionalizëm nga të gjitha institucionet e vendit. Njëkohësisht, kërkoj nga të gjitha mekanizmat institucionalë dhe shoqërorë që të bashkërendojnë politikat dhe aktivitetet, me qëllim të parandalimit të rasteve të tilla në të ardhmen", ka thënë Haradinaj.

Deputetët dënojnë rastin e abuzimit të 16-vjeçares nga Drenasi

Deputetët e Kuvendit të Kosovës përmes një seance plenare e kanë dënuar rastin e abuzimit të të miturës nga Drenasi. Deputeti Elmi Reçica, në emër të grupit parlamentar të PDK-së, ka thënë se ky rast është shumë i ndjeshëm. Ai ka kërkuar nga të gjitha autoritetet përgjegjëse të marrin të gjitha veprimet e duhura për ta trajtuar si duhet këtë rast. "Është një ngjarje dhe situatë shumë e rëndë, e cila ka shkaktuar hidhërim dhe tronditje të madhe në vend", është shprehur Reçica, duke shtuar se është shumë me rëndësi që e gjithë shoqëria të angazhohet për parandalimin e rasteve të tilla.

Ndërsa në emër të iniciuesit të seancës së jashtëzakonshme për rastin e të miturës nga Drenasi, deputetja e Lëvizjes Vetëvendosje, Fatmire Kollçaku, ka thënë se për shkak të dështimit të institucioneve, kanë kërkuar këtë debat. "Abuzimi filloi në shkollë dhe krimi vazhdoi në polici, duke vazhduar krimi dhe dhunimi. Ndërsa ndodhi abuzimi i tretë në një institucion privat që nuk kishte licencë dhe nuk kishte kushte për adaptim", ka thënë ajo.

Në anën tjetër, deputetja e LDK-së, Lirije Kajtazi, ka thënë se ligjet dhe mekanizmat institucionalë që mbrojnë të drejtat e njeriut në vend, nuk e kanë kryer detyrën e vet dhe ka munguar aderimi i problemeve reale.

Ndërkaq shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Ahmet Isufi, ka thënë se abuzuesit me nxënësen 16-vjeçare nga Drenasi duhet t'i marrin dënimet maksimale. Kurse

deputeti i PSD-së, Visar Ymeri, ka theksuar se shteti ka dështuar që t'i mbrojë gratë dhe vajzat nga abuzimet e ndryshme.

Seanca e jashtëzakonshme për rastin e të miturës nga Drenasi është thirrur nga Lëvizja Vetëvendosje, LDK-ja dhe Alternativa.

Aplikimi i Kosovës me projekte infrastrukturore në WBIF kap shumën dhjetëra milionë euro

EPOKA E RE A. MAVRAJ

PRISHTINË, 8 SHKURT - Në mbledhjen e Këshillit Kombëtar të Investimeve, ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka folur për mundësinë e aplikimit në sektorët shtesë të miratuar nga WBIF, si: infrastruktura digjitale, "Termokosi", ujëmbledhësi i Skenderajt, studimi i fizibilitetit dhe vlerësimi i ndikimit social dhe në mjedis për ngrohje në rajonin e Ferizajt, Gjilanit, Pejës, Prizrenit, Mitrovicës, Drenasit dhe Obiliqit.

Hoxha ka theksuar se studimi i fizibilitetit për avancimin e infrastrukturës në shëndetësinë sekondare dhe terciare, master plani për mbeturinat e ndërtimit dhe rrënimit për komuna, për ndërtimin e sistemit hidro-teknik Desivojcë - Kremenatë - Gjyrishevc, për ALKOGAP - tubacioni i gazit nga Shqipëria në Kosovë si dhe master planin e gazit për Kosovën.

Ministrja Hoxha ka theksuar rëndësinë e projekteve të reja që duhet të shtohen në kuadër të listës prioritare të projekteve infrastrukturore si dhe të bëhet rishikimi i listës në tërësi për asistencën teknike të Kornizës Investuese të Ballkanit Perëndimor (WBIF).

Në fund u miratua kjo listë e projekteve, të propozuara nga ministrja Hoxha dhe ministritë përkatëse që do t'i mundësojnë Kosovës të aplikojë në raundin e nëntë të thirrjes për aplikim me projekte konkrete në fondet e WBIF, të cilat kapin shumën e dhjetëra milionë euro, dhe që në mënyrë të drejtpërdrejtë do ta përmirësojnë jetën dhe mirëqenien e qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Kosova dhe Maqedonia e Veriut, marrëveshje në fushën e auditivit

PRISHTINË, 8 SHKURT (ER) - Në ambientet e Zyrës Kombëtare të Auditimit, auditori i përgjithshëm i Republikës së Kosovës, Besnik Osmani, dhe zëvendësi i Revizorit Kryesor Shtetëror të Republikës së Maqedonisë, Naser Ademi, kanë nënshkruar marrëveshje bilaterale për bashkëpunim në mes të dy institucioneve përkatëse. Me këtë rast, auditori i përgjithshëm Besnik Osmani u shpreh se bashkëpunimi në mes të dy institucioneve tona tani vetëm po formalizohet me nënshkrimin e marrëveshjes, kurse ka ekzistuar shumë më herët.

"Kjo marrëveshje ka për qëllim shtimin dhe fuqizimin e bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve tona, prandaj dua të shpreh gatishmërinë dhe dëshirën që të zhvillojmë një plan të aktiviteteve konkrete dhe me interes të përbashkët", ka thënë Osmani. Ndërsa Naser Ademi, zëvendës i Revizorit Kryesor Shtetëror të Republikës së Maqedonisë, tha se kjo marrëveshje është e mirë për shkak se fuqizohet fqinjësia dhe raportet e mira që janë në mes dy vendeve tona.

Krerët e të dyja institucioneve deklaruan se janë të përkushtuar për angazhimin e institucioneve të tyre për përmbushjen e kësaj marrëveshje, me anë të së cilës synohet të promovohet bashkëpunimi institucional, përmes shkëmbimit të përvojave në fushën e metodologjisë së auditimit të jashtëm publik, përkrahjen në zhvillimin e softuerëve të auditimit, trajnime profesionale, shkëmbim të informacionit dhe dokumentacionit mbi aktivitetet profesionale, organizimin e auditimeve paralele për tema me interes të përbashkët, mbajtje të konsultimeve, hulumtimeve të përbashkëta, seminareve, konferencave e takimeve teknike.

Shkaku i plaçkitjeve institucionet shtojnë sigurinë

Banka Qendrore e Kosovës (BQK), Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), Policia e Kosovës (PK) dhe Shoqata e Bankave të Kosovës (ShBK) kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për ngritjen e sigurisë në sektorin bankar. Marrëveshja ka për qëllim avancimin e bashkëpunimit për ngritjen e nivelit të sigurisë në sektorin bankar në mënyrë që bankat, personeli i tyre dhe qytetarët të kenë ambient sa më të sigurt për zhvillimin e aktivitetit të tyre

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 8 SHKURT - Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Fehmi Mehmeti, ka nënshkruar të premten marrëveshje të bashkëpunimit me ministrin e Punëve të Brendshme, Ekrem Mustafa, drejtorin e Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj dhe drejtorin ekzekutiv të Shoqatës së Bankave të Kosovës, Petrit Balija.

Kjo marrëveshje u nënshkrua si rezultat i takimeve të mëhershme të zhvilluara me përfaqësues të këtyre institucioneve, në të cilat u diskutua për shqetësimet rreth dukurisë së plaçkitjes së institucioneve financiare në Kosovë.

Marrëveshja ka për qëllim avancimin e bashkëpunimit për ngritjen e nivelit të sigurisë në sektorin bankar në mënyrë që bankat, personeli i tyre dhe qytetarët të kenë ambient sa më të sigurt për zhvillimin e aktivitetit të tyre. Me këtë rast, guvernatori Mehmeti ka falënderuar institucionet e angazhuara për arritjen e kësaj marrëveshjeje për bashkëpunimin dhe masat e ndërmarra me qëllim të ofrimit të një ambienti më të sigurt për institucionet financiare që operojnë në Kosovë.

Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë përmes një reagimi për media ka shprehur shqetësimin për plaçkitjet e armatosura ndaj bankave dhe bizneseve. "Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë e konsideron sektorin bankar në Kosovë si një nga sektorët më vital për zhvillimin ekonomik të vendit. Një sistem i qëndrueshëm bankar konsiderohet parakusht për rritjen e investimeve në vend si dhe për tërheqjen e investimeve të huaja direkte. Marrë parasysh rëndësinë e tij, Kosova është me fat që ka një sistem shumë stabil bankar. Oda Ekonomike Amerikane shpreh shqetësimin e saj lidhur me plaçkitjet e vazhdueshme të bankave, të cilat kohët e fundit janë bërë kërcënim për tërë sektorin dhe shoqërinë, duke marrë përmasa alarmuese", është thënë në reagimin e Odës Amerikane .

Sipas këtij reagimi, plaçkitjet e armatosura nuk kërcënojnë vetëm perceptimin e përgjithshëm për sektorin bankar, por përbëjnë edhe goditje kundër zhvillimit ekonomik të vendit, e rrjedhimisht edhe kundër të ardhmes së Kosovës. "Në sytë e investitorëve të huaj rastet e tilla japin përshtypjen e sistemit të dobët të sundimit të rendit dhe të ligjit, duke rritur pasigurinë e të bërit biznes. Oda Ekonomike Amerikane u bënë thirrje autoriteteve të sigurisë si dhe institucioneve të tjera përgjegjëse të vendit që të trajtojnë këtë çështje me seriozitet të lartë, duke marrë masa më të rrepta për ofrimin e sigurisë më të madhe për bankat dhe bizneset e tjera, si dhe për ruajtjen stabilitetit të përgjithshëm në vend", është theksuar në reagimin e Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë.

Këshilli i Investitorëve Evropianë ka mbështetur marrëveshjen e nënshkruar BQK-ja, MPB-ja, PK-ja dhe ShBK-ja. Sipas këtij këshilli, sektori bankar në Kosovë është një nga sektorët kryesorë me rol shumë të rëndësishëm për zhvillimin e ekonomisë së vendit si dhe për stabilitetin ekonomik të tij. "Plaçkitjet e vazhdueshme të bankave, të cilat kohët e fundit janë bërë kërcënim për tërë sektorin bankar, kanë arritur përmasa alarmuese dhe mund të kenë efekte zinxhirore negative në shoqërinë tonë, andaj iniciativa e sotme është një hap i rëndësishëm për parandalimin e këtyre dukurive negative", është thënë në komunikatën e Këshillit të Investitorëve Evropianë.

FMN-ja e shqetësuar me Ligjin për pagat, viti 2020 problematik

PRISHTINË, 8 SHKURT - Ndarja buxhetore për Ligjin për pagat, i cili është miratuar në Kuvendin e Kosovës më 2 shkurt të këtij viti, nga viti 2020 do të jetë pothuajse e pamundur të jetë në përputhje me kufizimet sipas rregullit. Kështu ka thënë në intervistën për "Radion Evropa e Lirë", Ruud Vermeulen, drejtor i Zyrës së Fondit Monetar Ndërkombëtar në Kosovë. "Nuk do të shkoja aq larg sa të them se Kosova po përballet me një krizë të afërt si pasojë e këtij ligji. Por, kjo nuk do të thotë se nuk jemi thellësisht të shqetësuar lidhur me ndikimin që do të ketë mbi buxhetin dhe konkurrueshmërinë e ekonomisë", ka thënë Vermeulen.

Ndër të tjera, ai ka thënë se kjo bën ngushtimin e shpenzimeve për sektorët prioritarë dhe do ta pengojë rritjen dhe krijimin e vendeve të reja të punës, që nevojiten për ta zvogëluar papunësinë e lartë në Kosovë dhe hendekun e gjerë të të ardhurave me vendet në rajon dhe BE, për rritjen e Bruto Produktit Vendor më 2018.

Bekim Jashari: Nuk do t'u faturohet prindërve pagesa e janarit në çerdhen 'Nëna Zahide'

Skenderaj, 8 shkurt (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka njoftuar opinion publik për vendimin që ka marrë në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit, që mos t'u faturohet prindërve pagesa e janarit për institucionin parashkollor "Nëna Zahide", për shkak të grevës së mësimdhënësve. "Prindër të nderuar të fëmijëve të çerdhes 'Nëna Zahide', po e ndaj me ju një informatë që ka të bëjë me pagesën mujore për muajin janar, për institucionin parashkollor 'Nëna Zahide'. Kemi marrë vendim që mos të faturohet pagesa e janarit për shkak të grevës së mësimdhënësve. E kemi parasysh faktin se gjatë kohës që zhvillohej greva disa prindër është dashtë të paguajnë kujdestari private për fëmijët e tyre", ka thënë kryetari Jashari.

Deçani përfiton 46 000 euro për efiçiencë të energjisë

Deçan, 8 shkurt (ER) - Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, dhe kryetari i Deçanit, Bashkim Ramosaj, kanë nënshkruar memorandum bashkëpunimi për "Promovimin e efiçiencës së energjisë në nivel lokal përmes zbatimit të masave të efiçiencës së energjisë". Ramosaj ka thënë se ky është një fillim i mbarë dhe se, përveç kësaj marrëveshje, ka edhe disa tema të tjera që duhen biseduar për Komunën e Deçanit. "Kemi pasur një takim pune me ministrin Valdrin Lluka, me të cilin nënshkruam memorandum bashkëpunimi për efiçiencë. Ky është një fillim i mbarë dhe besoj se edhe në të ardhmen kemi për ta vazhduar bashkëpunimin", ka thënë Ramosaj. Ndërsa ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, ka thënë se, përveç ndikimit publik me efiçiencë, do të krijojnë edhe kapacitete rezervë për ujë të pijes. "Do t'i shikojmë mundësitë e rigjenerimit të ujit për hidro dhe mbulimin për rrjetet e energjisë elektrike në disa vende. Për efiçiencë kemi ndarë 46 mijë euro", ka thënë Lluka.

Drejtoria e Inspeksionit mbylli disa lokale në Mitrovicë

Mitrovicë, 8 shkurt - Drejtori i Inspeksionit, Hysni Ahmeti, në bashkëpunim me policinë, ka kryer kontrolle inspektuese sipas detyrës zyrtare në disa subjekte afariste në rajonin e qytetit të Mitrovicës.

Qëllimi i këtyre inspektimeve ka të bëjë me respektimin e orarit të punës nga bizneset e përfshira në këtë kontroll të cilat zhvillojnë veprimtaritë e tyre pas orës 23:00.

Drejtoria e Inspeksionit ka bërë me dije se këto subjekte afariste janë udhëzuar të pajisen me leje të veçanta për zgjatje të orarit të punës, por të njëjtit nuk e kanë respektuar një gjë të tillë. "Gjatë këtij aksioni janë inspektuar gjithsej pesë subjekte afariste hoteliere, pas inspektimit u konstatua se nuk janë pajisur me leje për zgjatje të orarit të punës në bazë të Rregullores Komunale Nr. 03/2014 për caktim të orarit të punës për veprimtaritë hoteliere. Me këtë rast Inspektorati i Tregut dhe ai Sanitar kanë marrë masa konform ligjeve në fuqi dhe kanë ndaluar përkohësisht zhvillimin e veprimtarive të këtyre subjekteve hoteliere deri në eliminimin e parregullsive", është thënë në njoftimin e Komunës së Mitrovicës.

Dhjetë shkolla të Gjilanit pajisen me tabela të mençura

Gjilan 8 shkurt (ER) - Dhjetë shkolla të Komunës së Gjilanit janë pajisur me tabela të mençura të cilat do të kenë ndikim të drejtpërdrejtë inovativ të integruar në mësimdhënie dhe mësimnxënie sipas standardeve të shekullit 21.

Drejtori i Drejtorisë së Arsimit, Nazim Gagica, ka thënë se me furnizimin e tabelave të mençura, Gjilani po u përgjigjet me ritëm të shpejtë zhvillimeve dhe ndryshimeve në qasjen e mësimdhënies dhe mësimnxënies, duke shfrytëzuar avantazhet e teknologjisë së informatikës si kusht themelor i procesit të reformës kurrikulare. "Përmes tabelave të mençura nxënësit dhe mësimdhënësit do t'i përmbushin nevojat për të nxënit interaktiv, trajtim gjithëpërfshirës të temave, punë të pavarur, dominim të punës individuale dhe grupore e kontroll të drejtpërdrejtë", ka deklaruar Gagica.

Askush nuk mund t'i bëjë gjyq UÇK-së

Prof. Lisen BASHKURTI

Në historinë moderne të popullit shqiptar pavarësia e Kosovës është arritja më e madhe. Në këtë arritje rolin themelor e luajti Ushtria Çlirimtare e Kosovës, e cila është krenari kombëtare. Gjatë procesit të shpërbërjes së ish-Federatës Jugosllave u përplasën interesa politike, ndëretnike, ekonomike dhe gjeopolitike. Ndër beteja u ndeshën ushtria tradicionale jugosllave, e cila ishte e dominuar dhe e kontrolluar nga Serbia dhe një sërë ushtrish të reja që u krijuan në lufte sipër.

Analiza e ushtrive të reja të krijuara gjatë shpërbërjes së Jugosllavisë është një nga indikacionet kryesore për t'i kuptuar aktorët e luftërave, qëllimet e tyre, burimet e mbështetjes së brendshme dhe orientimet gjeopolitike ndërkombëtare të vendeve e popujve që u përfshinë në këtë konflikt. Nga kjo analizë e ushtrive të luftës shpërbërëse të Jugosllavisë rezulton se Ushtria Çlirimtare e Kosovës ka tipare shumë të ndritura dhe të dallueshme, për të cilat shqiptarët do të jenë përherë krenarë.

Së pari, Ushtria Çlirimtare e Kosovës u krijua tërësisht nga populli shqiptar i Kosovës. Asnjë mercenar nuk ka pasur në radhët e saj, as ushtarë të thjeshtë dhe as krerë drejtues politikë dhe ushtarakë të saj. Ndërkohë thuajse në të gjitha ushtritë e tjera si në ish-Armatën Jugosllave, ashtu edhe ato të krijuara në Kroaci dhe Bosnje & Hercegovinë, ka pasur mercenarë dhe të huaj në të gjitha nivelet. Si e tillë, Ushtria Çlirimtare e Kosovës nuk u ndikua nga faktorë gjeopolitikë të huaj as gjatë luftës dhe as pas saj.

Së dyti, Ushtria Çlirimtare e Kosovës lindi në territorin e Kosovës dhe luftoi vetëm brenda tij. Duke qenë shumë e qartë në qëllimin e saj, kjo ushtri luftoi për mbrojtjen e popullsisë shqiptare nga shfarosja e dhunshme serbe si dhe për çlirimin e vendit njëherë e përgjithmonë nga kolonializmi serb. Shumica e ushtrive të tjera në Jugosllavi gjatë luftës shpërbërëse tejkaluan territoret e shteteve dhe kryen veprime ushtarake pushtuese dhe kriminale mbi popujt fqinjë. Ushtria Çlirimtare e Kosovës nuk bëri as krime lufte, as gjenocid dhe as pastrime etnike mbi pakicat e ndryshme që jetonin në Kosovë dhe nuk ndërmori asnjë veprim ushtarak pushtues e kriminal jashtë territorit të Kosovës.

Së treti, Ushtria Çlirimtare e Kosovës qysh në themelimin e saj u krijua mbi një strukturë politiko-ushtarake shumë moderne dhe profesionale. Ajo funksionoi me hierarki, me strategji, me rregullore rigoroze ushtarake, me uniforma dhe armatime ndërkombëtarisht të lejueshme për luftë. Ndërkohë, në disa ushtri të tjera u krijuan forca paramilitare ose paralele si dhe u përdoren armë kimike, mina kundër personit etj. Kjo do të thotë që Ushtria Çlirimtare e Kosovës, ndonëse më e reja në gjithë ish-Jugosllavinë, respektoi plotësisht zakonet dhe ligjet e luftës.

Së katërti, Ushtria Çlirimtare e Kosovës u financua nga burimet vullnetare të popullit shqiptar në atdhe dhe në diasporë. Fondi Vendlindja Thërret si dhe mbështetjet e tjera dytësore kanë qenë baza e blerjes së uniformave, armatimeve, municioneve, mjeteve logjistike dhe nevojave të tjera të luftës. Asnjë ndihmë nuk ka marrë kjo ushtri nga shtete, grupe apo individë të huaj me të kaluar trafikante, kriminale, pastrimi parash apo terroriste. Ushtritë e tjera patën edhe burime të errëta financuese nga shtete, grupe apo individë me të kaluar kriminale, ekstremiste dhe terroriste. Kjo do të thotë se Ushtria Çlirimtare e Kosovës u krijua dhe mbeti e pastër në qëllimin, përbërjen dhe veprimtarinë e saj politiko-ushtarake.

Së pesti, Ushtria Çlirimtare e Kosovës nuk funksionoi si forcë rebele, guerile, revolucionare dhe e izoluar. Ajo u orientua menjëherë gjeopolitikisht drejt Perëndimit dhe strategjikisht drejt NATO-s. Kjo ushtri e re u vetorientua si pjesë e Aleancës Euro-Atlantike dhe e tillë mbeti deri në përmbushjen e misionit të saj.

Së gjashti, Ushtria Çlirimtare e Kosovës luajti edhe misione shumë të rëndësishme politike dhe diplomatike gjatë dhe pas luftës. Kjo ushtri u njoh ndërkombëtarisht si legjitime e popullit të Kosovës, hyri në kontakte dhe bisedime ndërkombëtare, mori pjesë në Konferencën e Rambujesë si dhe, kur mbaroi lufta, u shndërrua në mënyrë të vullnetshme në institucion politik qytetar, modern dhe demokratik që merr pjesë aktivisht në jetën pluraliste politike të Kosovës. Kjo do të thotë që vlerat e mëdha atdhetare, politike dhe morale, kombëtare dhe ndërkombëtare Ushtria Çlirimtare e Kosovës i barti pas luftës në proceset për pavarësi, shtetformim dhe demokraci në Kosovën e lirë, të pavarur dhe demokratike.

KDI-ja: Infrastrukturë e dobët dhe gjendje emergjente në shkolla

KAMENICË, 8 SHKURT (ER) - Shkollat në Kosovë vazhdojnë të mos kenë infrastrukturë të duhur për mbajtjen e procesit mësimor. Shumë nxënës ende mësojnë në objekte të vjetra shkollore e në kushte jo të mira higjienike, e që paraqesin rrezik për jetën dhe shëndetin e nxënësve.

Një ndër to është edhe shkolla "Fan S. Noli" në Kamenicë. Në këtë shkollë gjendja e tualeteve është e rëndë. Instituti Demokratik i Kosovës ka mbajtur një takim mes prindërve të nxënësve të kësaj shkolle dhe përfaqësuesve komunalë, në kuadër të takimeve që KDI-ja ka zhvilluar për t'i identifikuar problemet që kanë banorët në komuna të ndryshme të Kosovës, gjatë zbatimit të projektit "Rritja e llogaridhënies së institucioneve të qeverisjes lokale".

Prindërit kanë kërkuar që të intervenohet për rregullimin e këtyre tualeteve, duke shtuar se fëmijët e tyre janë të rrezikuar. Ilirjana Maloku thotë se fëmija i saj është rrëzuar në shkallët që të shpien në tualet, duke pësuar lëndime në kokë.

Arian Mavriqi, gjithashtu prind i një prej nxënësve, ceki se rregullimi i këtyre tualeteve është emergjencë. Prindërit, gjithashtu, theksuan se më 20. 9. 2018 me 32 nënshkrime e kanë përcjellë ankesën te Ministria e Arsimit, kryetari i Komunës, Qëndron Kastrati dhe te drejtori i shkollës, Mustafa Rrudhani, që të ndërmerret diçka sa më shpejt. Sipas tyre, deri më tani komuna nuk ka ndërmarrë asgjë rreth kësaj çështje, duke bërë që prindërit çdo ditë e më shumë të shqetësohen rreth shëndetit të fëmijëve të tyre.

Zyrtari komunal nga drejtoria E Arsimit, Sabri Morina, ceki se këto shqetësime do t'i adresojë në komunë që të ndërmerret diçka. Ky takim është pjesë e projektit "Rritja e llogaridhënies së institucioneve të qeverisjes lokale" dhe financohet nga Ambasada e Britanisë në Prishtinë.

Roth: Athina dhe Shkupi kontribuuan në historinë evropiane

Berlin, 8 shkurt - Me Marrëveshjen e Prespës, Shkupi dhe Athina kanë kontribuar në historinë evropiane, deklaroi ministri i Shtetit për Çështjet Evropiane të Ministrisë së Jashtme të Gjermanisë, Michael Roth.

"Ne gjermanët admirojmë guximin dhe jemi mirënjohës për këto gjëra", tha ai duke shtuar se "shqetësimet e grekëve se marrëveshja do të çonte në humbje ishin të pabaza".

"Përkundrazi, pas zgjidhjes së çështjes së emrit pas 27 vjetësh, njerëzit në të vërtetë do të përfitojnë shumë. Marrëdhëniet e mira fqinjësore, pajtimi dhe bashkëpunimi janë parakushte për paqen, stabilitetin dhe prosperitetin në të dy vendet, por edhe për BE-në", tha ai.

Roth theksoi se "të rinjtë, veçanërisht, ata grekë dhe ata të Maqedonisë së Veriut më në fund do të takohen dhe do të krijojnë miqësi, duke lënë prapa paragjykimet".

Grindja me Italinë, Franca tërheq ambasadorin nga Roma

Pas grindjeve prej disa javësh në mes të Qeverisë së Francës dhe Qeverisë populiste të djathtë në Romë, Parisi ka tërhequr për konsultime ambasadorin e vet nga Roma. Qeveria italiane prej kohësh është në konflikt me Macronin, ndër të tjera, për shkak të politikës së saj restriktive ndaj emigracionit

Paris, 8 shkurt - Pas grindjeve prej disa javësh në mes të Qeverisë së Francës dhe Qeverisë populiste të djathtë në Romë, Parisi ka tërhequr për konsultime ambasadorin e vet nga Roma. "Ndërhyrjet e fundit të Italisë në politikën e brendshme franceze janë një provokim i papranueshëm. Mbështetja e lëvizjes së jelek-verdhëve nga politika e Romës cenon respektin, për të cilin janë të detyruara ndaj njëra-tjetrës qeveritë e zgjedhura në mënyrë demokratike dhe të lirë", thuhet në komunikatën e Ministrisë së Jashtme franceze.

Përfaqësuesi i Qeverisë franceze u shpreh i indinjuar edhe ndaj takimit të fshehtë të zëvendëskryeministrit italian Luigi Di Maio me përfaqësues të "jelekverdhëve" të martën në Paris.

Vetëm katër muaj para zgjedhjeve për Parlamentin Evropian, qeveria në Romë fare hapur është angazhuar për lëvizjen e protestës, që kërkon tërheqjen e presidentit Macron. Kalkulimi që me sa duket bëjnë populistët është të fitojnë pikë në elektorat për zgjedhjet evropiane.

Di Maio nga lëvizja populiste "Pesë yjet" është takuar me disa kandidatë të "jelekverdhëve" për zgjedhjet evropiane në fund të majit, ndër ta edhe me zëdhënësin e lëvizjes së protestës, Christophe Chalençon. Ky është si figurë e diskutueshme për shkak të deklarimeve të tij ksneofobe dhe kundër islamizmit.

Qeveria italiane prej kohësh është në konflikt me Macronin, ndër të tjera, për shkak të politikës së saj restriktive ndaj emigracionit. Macroni e akuzoi Romën për "cinizëm" dhe "mungesë përgjegjësie", pasi Italia refuzoi ta pranojë ankorimin në portet e saj të anijeve me refugjatë. Di Maio u kundërvu duke deklaruar se emigrimi masiv nga Afrika është pasojë, që vende të caktuara evropiane, në radhë të parë Franca, asnjëherë nuk janë ndalur së kolonizuari vendet afrikane.

Trumpi shpreson që kriza politike në Virxhinia ta ndihmojë në rizgjedhje

Uashington, 8 shkurt - Presidenti amerikan Donald Trump parashikon që kaosi që ka përfshirë zyrtarët kryesorë të shtetit të Virxhinias, të tre demokratë, do ta ndihmojë atë që të sigurojë fitore në atë shtet kur të kandidojë për një mandat të dytë në vitin 2020.

Megjithëse Trumpi fitoi zgjedhjet presidenciale në vitin 2016, ai humbi në Virxhinia ndaj rivales demokrate Hillary Clinton. Dhe në vitet e fundit, ai shtet ka pasur prirjen të zgjedhë demokratë në zgjedhjet e shtetit.

Por së fundmi ka pasur thirrje që guvernatori Ralph Northam dhe Prokurori i Përgjithshëm i shtetit, Mark Herring, të japin dorëheqje pasi pranuan se kishin bërë veprime që denigronin afrikano-amerikanët, duke lyer fytyrën me ngjyrë të errët, para më shumë se

dy dekadash. "Ne nuk po reagojmë ndaj një akti. Ne po reagojmë ndaj asaj që përfaqëson akti. Nëse fillon me premisën e gabuar, arrin në përfundime të gabuara dhe ka përpjekje që ta minimizojnë këtë, duke e quajtur një veprim të papeshuar rinie. Jo, është më thellë se kaq", tha ai.

Reverendi Al Sharpton është në valën e një numri politikanësh, si demokratë dhe republikanë, që po bëjnë thirrje për dorëheqjen e guvernatorit.

Ndërkaq zyrtari i dytë më i rëndësishëm i shtetit, zëvendësguvernatori Justin Fairfax, po përballet me akuza për sulm seksual. Fairfax nuk mohon që ka pasur një marrëdhënie me gruan që e ka akuzuar, para se të martohej, por thotë se nuk e ka sulmuar. Nëse të tre zyrtarët detyrohen të japin dorëheqje, kreu republikan i Dhomës së Delegatëve të Virxhinias, Kirk Cox, do të bëhej guvernator, duke marrë udhëheqjen e shtetit nga demokratët.

Merkeli: Shteti Islamik nuk është mposhtur

Berlin, 8 shkurt - Grupi militant Shteti Islamik nuk është mposhtur, tha të premten kancelarja gjermane Angela Merkel. Këto deklarata që janë në kundërshtim me ato të presidentit të Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, Merkel i bëri në inaugurimin e selisë së re të shërbimit të inteligjencës në Berlin. "I ashtuquajturi Shtet Islamik, për fat të mirë, është dëbuar nga territori që ka uzurpuar por kjo, për fat të keq, nuk do të thotë se Shteti Islamik është zhdukur. Ai po transformohet në një forcë asimetrike të luftës. Dhe një gjë e tillë sigurisht se paraqet kërcënim", tha Merkeli. Ajo shtoi se monitorimi i ngjarjeve në luftën e Sirisë është një nga prioritetet kryesore të shërbimit gjerman të inteligjencës, ashtu si edhe ndjekja e kërcënimeve nga sulmet kibernetike dhe lajmet e rreme.

Trumpi ka deklaruar javë më parë se Shteti Islamik është mposhtur dhe se ai do t'i tërheqë trupat amerikane nga Siria, ku militantët e grupit islamik, deri vonë, kanë pasur nën kontroll disa territore.

Plani për tërheqje i ka alarmuar aleatët evropianë që kanë frikë se Shteti Islamik do të ringjallet në Siri, në mungesë të një plani të besueshëm të paqes që do t'i jepte fund luftës civile në këtë vend.

Libri 'Lamtumirë Baca Adem' pasqyron dhimbjen dhe krenarinë e ligjshme për nderin e kombit, Adem Demaçin

(Selatin Novosella, "Lamtumirë Baca Adem", botoi Shoqata e të Burgosurve Politikë të Kosovës, Prishtinë, 2019)

Ibish NEZIRI

Vargut të titujve të librave të Selatin Novosellës për Nderin e Kombit, Adem Demaçin, në vitin që sapo e përcollëm iu shtua edhe një titull, të cilin sigurisht se asnjëherë nuk do të donim ta kishim, por ja që, pos që e kemi, edhe po e promovojmë sot këtu. Është ky libri më i ri i këtij autori, i titulluar "Lamtumirë Baca Adem", libër ky jo i zakonshëm si gjithë librat e tjerë, por krejtësisht i pazakonshëm e, mbase, edhe i vetmi i këtij lloj në gjuhën shqipe.

Posa lexuesi ta marrë në dorë këtë libër, pos vetë titullit, edhe fotografia në kopertinë ia bënë të qartë përmbajtjen, një përmbajtje të dhimbshme, por edhe krenare.

Libri i ka 327 faqe dhe i paraprinë "Testamenti i Bacës Adem Demaçi", i cili përfundon me porosinë që njerëzit të mësohen të shkojnë prapa ideve, të mos shkojnë prapa njerëzve, sepse njerëzit mund të burgosen, mund të sëmurën, mund të vdesin, kurse idetë nuk vdesin kurrë, por edhe ndonëse nuk është përfshirë në testament, por që shpeshherë ka ditur ta thotë vetë Baca Adem, njerëzit edhe mund të gabojnë.

Pas "Testamentit" vjen përkushtimi i prof. dr. Zymer Nezirit, përkushtim përplot ndjenja e krenari, përkushtim që me pak fjalë Bacën Adem e vendos në vendin që i përket. Ai me të drejtë Bacës Adem i thotë "Baca Adem, ti ishe vetë Atdheu, vetë liria, vetë bashkimi, vetë ideali, sakrifica, qëndresa, drejtësia, vetë UÇK-ja, vetë historia!"

Nëse duhet folur për rëndësinë e këtij libri, atëherë mund të them se ky libër është i një rëndësie të veçantë, sepse në të, nëse i lëmë anash fjalët e politikanëve dhe udhëheqësve të ndryshëm andej e këndej kufijve mes shqiptarësh, (të cilat thjesht janë stereotipa), në vete përmban njoftimin për tubimet komemorative duke filluar nga ai në Kuvendin e Republikës së Kosovës, ceremoninë e varrimit, fjalët e udhëheqësve shtetërorë nga Republika e Kosovës dhe ajo e Shqipërisë, të kryetarit të Kuvendit të Maqedonisë, të liderit të BDI-së në Sheshin "Skënderbeu" si dhe fjalën lamtumirëse të autorit të librit, në varrezat e dëshmorëve, para trupit të Nderit të Kombit Adem Demaçit - Bacës si dhe njoftimet për tubimet e tjera komemorative e homazhet e mbajtura në Prishtinë, Prizren dhe Tiranë nga institucione të ndryshme të arsimit e të kulturës si dhe fjalët e mbajtura në këto tubime komemorative.

Në libër janë futur edhe shkrime të ndryshme mes të cilëve ai i akademik Rexhep Qosjes, i cili "Mandatin e Adem Demaçit e quan mandat të gjithëkohshëm", i Sabri Kiçmarit, shkrimi i Blerim Shalës dhe telegrame të shumë personaliteteve të politikës dhe kulturës, si i ish-presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha, ish-kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Jakup Krasniqit, Ismail dhe Elena Kadaresë, Azem Sylës, ish-shef i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, Edi Ramës, kryeministër i Republikës së Shqipërisë, gjeneralit Kudusi Lama, kryeimamit të Kosovës, Naim Tërnavës, i ipeshkvit të Kosovës, Dodë Gjergjit, e telegrame të tjera të shumë personaliteteve të tjerë që me notat më të larta e vlerësojnë këtë figurë madhore të kombit tonë. Me këtë rast nuk do t'i lë pa i përmend edhe telegramet e dy zonjave që vijnë nga fqinji ynë verior, Serbia, telegramin e zonjës Sonja Biserkos, e cila shkruan: "Adem Demaçi është pa dyshim ndër mbrojtësit më të spikatur të të drejtave të njeriut në Ballkan, me një prej karrierave më të gjata për promovimin e të drejtave të njerëzve, gjë për të cilën u burgos për një kohë tejet të gjatë, plot 28 vjet. I quajtur Mandela i Ballkanit dhe lider ideologjik i shqiptarëve të Kosovës, Demaçi ka qenë mishërim i qëndresës kombëtare të Kosovës".

Ndërkaq Llatinka Peroviq, ish-politikane serbe, pasi që Bacën Adem e quan legjendë, shkruan: "Adem Demaçi, pas luftës, udhëtoi për në Beograd dhe opinionit publik iu drejtua me këto fjalë: Kam ardhur në Beograd si njeri, e jo si shqiptar, që të bisedoj me njerëz se si t'i tejkalojmë konfliktet dhe të jetojmë në paqe", me çka pa dyshim se me këtë zonja Peroviç i ka vënë në pah, pa e thënë në mënyrë eksplicite, pos vlerave kombëtare të Adem Demaçit, edhe vlerat e tij universale. Por, më e veçanta e këtij libri qëndron në faktin se



në të janë përfshirë përshtypjet dhe vlerësimet e shprehura me pak fjalë e rreshta në Librin e Zisë, apo thënë më mirë në librin e kujtimeve, i cili qëndroi i hapur nga mbledhja komemorative në Kuvendin e Kosovës për disa ditë me radhë.

Përshtypjet dhe vlerësimet që gjenden brenda kopertinave të këtij libri nuk janë thjesht vetëm fjalë, por janë shprehje e ndjenjave dhe respektit për njeriun e sfidave të mëdha, për njeriun që na mësoi ABC-në e dashurisë për atdheun, që na mësoi artin e vetëflijimit dhe artin e rezistencës për liri, fjalë të dala nga shpirti i popullit, pothuajse asnjëherë të thëna në këtë mënyrë e kaq dhimbshëm, por edhe kaq sinqerisht.

Mes emrave të nënshkruar në librin e zisë, janë përplot emra të njohur që edhe më parë kanë pasur mundësinë ta thonë mendimin apo vlerësimin e tyre edhe publikisht, emra miqsh e shokësh, emra bashkëveprimtarësh, por edhe emra të tillë, krejtësisht të panjohur, që edhe më herët, ndonëse do të kishin dashur ta thoshin mendimin e tyre për Bacën Adem, ta jepnin vlerësimin e tyre për Bacën Adem, nuk iu ishte dhënë rasti, as mundësia, e thanë me këtë rast.

Në vlerësimet e tyre, miq, shokë e bashkëveprimtarë, të njohur e të panjohur Adem Demaçin e quajnë mësues, frymëzues, lis në furtunë, të pathyeshëm, hero, legjendë dhe plot epitete të tjera krejtësisht të merituara. Madje patë të tillë që ashtu si i shohim në libër, edhe ju betuan Bacës Adem, se do ta vazhdojnë luftën, të cilën ai me punën dhe angazhimin e qëndresën e vet na kishte mësuar. Naim Ramadani, ndër të tjera, shkruan: "Baca Adem, të betohem se do të punojmë derisa ta bëjmë Shqipërinë etnike!", bërja e së cilës ishte një gjakim i Adem Demaçit. Një i ri, i quajtur Yll Bajraktari, shkruan: "U rrita me veprën tënde o Baca Adem. Nuk e mendoja kurrë se mund të na lini. Ti ndërrove jetë në ditëlindjen time. Kurrë përjetë i paharruar!" dhe unë tani do të shtoja: Po cili nga ne nuk u rrit me veprën e Adem Demaçit, nuk u rrit me mësimet e tij, me shëmbëlltyrën e tij prej kolosi. Të gjithë u rritem me të, u forcuam me të, nga ai u mësuam të luftojmë për liri.

Dhimbja dhe krenaria për Nderin e Kombit, Adem Demaçin, të shprehura në librin e kujtimeve, janë të pafundme, ashtu siç ishin edhe mësimet, përpjekjet e lufta e tij për çlirim e bashkim kombëtar, prandaj edhe është e vështirë të përmenden një për një në një fjalë promovuese të librit të gjitha, por sikur më duket se nëse disa nga ato shënime nuk i sjell në këtë fjalë, iu hy në hak si Ismail Gjoshit: "Jeta dhe vepra juaj është historia jonë!", i një tjetri me emrin Isa, i cili thotë: "Për ty dhe atdheun kurrë nuk është mjaft! Ia vlen edhe të vdesësh!", po ashtu edhe një Marini e Bukurie të cilët në mesin e një dore të vogël të vizatuar shkruajnë: "Të duam Baca Adem! Marini dhe Bukuri".

Shënimi i veprimtares së vjetër dhe mikes së çmuar të Bacës Adem, Xhemile Deharit, është mjaft prekës. Ajo shkruan: "Baca Adem, nuk do të harrojmë kurrë, se na mësove shumë. Edhe djemtë e mi vdiqën me mësimin tënd. Nuk mund ta harroj edhe daljen tuaj prej burgut, se në atë kohë më lindi Astriti, po edhe ditëlindjen e keni të njëjtë. I lehtë ju qoftë dheu i Kosovës!.

Edhe preshevari Fatmir Arifi, i cili në atdheun e vet është refugjat, shkruan: "Me ty Bacë u rritëm e u burrëruam me idealet e larta, dhe u frymëzuam nga vepra jote. Lavdia të takon ty, Bacë!"

Mund të vazhdohet edhe gjatë me shënimet e librit të kujtimeve për Bacën Adem, por meqë edhe të tjerë do të flasin, unë dua edhe një herë të theksoj se të gjitha shënimet në këtë libër e nxjerrin edhe një herë para nesh gjithë madhështinë e emrit të Nderit të Kombit Adem Demaçit dhe veprës së tij, për çka e ndiej si detyrim ta falënderoj Selatin Novosellën për përgatitjen e këtij libri dhe ardhjen e tij sot këtu, në këtë promovim.

Miq të nderuar, meqë libri hapet me testamentin e Bacës Adem Demaçit, dhe unë fjalën time e nisa po nga ky testament, po e përfundoj me një testament tjetër po të Bacës, të dëgjuar shpeshherë nga ai vetë si mësim e amanet, i cili gjendet në mes të shënimeve të shumta edhe në këtë libër kujtimesh.

Le të jetë përcjellje e amanetit Adem Demaçit te ju dhe te brazat që vijnë: "Bacë, kur njeriu zgjohet nga gjumi, duhet të mendojë se është njeriu më i rëndësishëm në mesin e popullit të tij dhe jo vetëm kaq! Ai duhet të punojë dhe veprojë sikur krejt fati i kombit dhe atdheut varet prej tij e në fund, kur të shkojë në shtrat, t'ia kushtojë pesë minuta kohë të përgjigjet në pyetjen: Çka bëra sot të vlefshme për popullin tim, për atdheun tim!"

(Recension i lexuar në përurimin e librit, në Bern, më 19 janar 2019, organizuar nga Ambasada e Republikës së Kosovës në Zvicër)

E jashtëzakonshme

Fiton dy herë lotarinë duke përdorur datën e vdekjes së mamasë

Një burrë ka përdorur një strategji mjaft efikase kur luajti lotari me numrat e tij fitues pasi mori një çmim prej 10 mijë dollarësh për herë të dytë për vetëm disa muaj. "Kam fituar me të njëjtat shifra si në gusht" ka thënë 58-vjeçari nga Maryland. Ai ka treguar se në të dyja rastet përdori datën e vdekjes së nënës së tij.

FOTO E DITES

Një pamje ajrore e pyjeve Vosges në Oderen të Francës. /AFP/

E rrallë

Kurorat e vjedhura me vlerë 7 milionë dollarë gjenden në kosh të plehrave

Thesari mbretëror suedez që u vjedh nga një katedrale vitin e kaluar është gjetur në një kazan plehrash në Stokholm. Dy kurora dhe një spektër që datojnë në vitin 1961 u morën nga Katedralja Strangnas në perëndim të Stokholmit më 31 korrik 2018. Bizhuteritë, që u përdorën për funeralin e Mbretit Karl IX dhe të Mbretëreshës Kristina, janë me vlerë 7 milionë dollarë. Një zëdhënëse e policisë ka thënë për "Sky News" se tani po punohet për të përcaktuar nëse janë me të vërtetë bizhuteritë e vjedhura.

BARSOLETA E DITËS

Një vajzë po kalonte në rrugë me qenin e vet dhe një djalë i thotë:
- Ku shkon me atë dhi, moj!?
- Nuk është dhi, po qen, o injorant!, i thotë ajo.
- Nuk e kisha me ty, po me qenin, moj, - i gjegjet ai.

Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 16:00

"THE GRINCH" 3D,

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 ore 30 min

Rolet: Benedict Cumberbatch, Rashida Jones, Kenan Thompson, Cameron Seely, Angela Lansbury, etj.

Regjia: Scott Mosier, Yarrow Cheney

Në ora 17:30

"THE NUTCRACKER AND THE FOUR REALMS" 3D

Aventure/Fantazi/Familjar; 1 ore 39 min

Rolet: Keira Knightley, Mackenzie Foy, Eugenio Derbez, Mathew Macfayden, Helen Mirren, Morgan Freeman, etj.

Regjia: Lasse Hallstrom, Joe Johnston

Në ora 19:30

"MORTAL ENGINES" 3D,

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Hugo Weaving, Hera Hilmar, Robert Sheehan, Jihae, Ronan Raftery, Leila George, Patrick Malahide, Stephen Lang, etj.

Regjia: Christian Rivers

Në ora 22:00

"HUNTER KILLER",

Aksion/Aventure/Fantazi; 2 ore 08 min

Rolet: Gerard Butler, Gary Oldman, Common, Linda Cardellini, Toby Stephens, Michael Nyqvist, Caroline Goodall, etj.

Regjia: Donovan Marsh

Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

DASHI
Në përgjithësi kjo ditë është e qetë dhe ju do të jeni mjaft i relaksuar për të dalë me shoqërinë ose me kolegët.

DEMI
Dita e sotme do t'ju shtyjë të merrni vendime aspak të lehta për ju. Momentet e nervozizmit mund t'ju bëjnë të thoni diçka që do të pendoheni më pas.

BINJAKËT
Sot do të gjendeni duke kujtuar momente të këndshme nga fëmijëria juaj. Pasdite do të kërkoni një mik që keni kohë pa e takuar.

GAFORRJA
Është një fazë mjaft pozitive e jetës suaj që do t'ju bëjë më të hapur dhe më të dashur me ata persona që kishit dyshime dhe qëndronit skeptik.

LUANI
Keni mjaft vullnet dhe prireni t'i përballoni edhe situatat e vështira. Sot do të vini në provë krenarinë tuaj lidhur me një person të veçantë.

VIRGJËRESHA
Sot do të merreni me punët e shtëpisë suaj dhe jeni shumë të zënë me çështjet e arredimit. Kërkoni ndihmën e një miku.

PESHORJA
Edhe pse sot jeni shumë të stresuar për shkak të një problemi, do të arrini t'i mbani nën kontroll emocionet tuaja.

AKREPI
Sot do të pendoheni për diçka që i keni bërë partnerit. Një ndjenjë e lehtë për dikë tjetër ju ka prishur ekuilibrat në marrëdhënie.

SHIGJETARI
Një ndjenjë e fortë miqësore sot do të shndërrohet në pasion. Do të lidheni shumë me dikë që ka qenë miku juaj.

BRICJAPI
Një udhëtim pune do të dalë më i frytshëm nga sa e mendonit. Shumë shpejt do t'ju duhet të merrni një vendim të rëndësishëm.

UJORI
Sot do të ndiqni zemrën në të gjitha vendimet që do të merrni. Në shumë raste edhe mund të gaboni, duhet të zgjidhni me arsye.

PESHQIT
Intuita ju çon të mendoni një zgjidhje të shpejtë për një problem që do të dalë sot gjatë ditës. Nuk do të gaboni në zgjedhjen tuaj.

Heidi Klum e ka caktuar datën e martesës

Heidi Klum nuk bën shaka kur vjen puna te planifikimi i dasmës së saj. Supermodeluesja 45-vjeçare ka bërë me dije në një intervistë për "ET" se ajo dhe i fejuari i saj Tom Kaulitz tashmë kanë caktuar datën për kurorëzimin e dashurisë së tyre. "Po, mendoj se ne kemi vendosur për datën. Do ta kuptoni së shpejti", ka thënë Klum.

Justin Bieberi dhe Hailey Baldwin zyrtarisht janë burrë dhe grua



Këngëtari kanadez Justin Bieber dhe modeluesja Hailey Baldwin zyrtarisht shihet se janë martuar. Këtë lajm e kanë bërë me dije vetë pasi patën paraqitjen e parë para mediave dhe fansave të tyre si burrë dhe grua. Në një intervistë për "Vogue" ata u paraqitën si burrë dhe grua.

Dua Lipa zbulon lajmin e mrekullueshëm

Mbrëmjen e së dielës zhvillohet ceremonia e ndarjes së çmimeve Grammy. Këngëtarja Dua Lipa ka zbuluar lajmin fantastik. Ajo do të debutojë në mbrëmjen gala me performancën e saj dhe do të dhurojë spektakël në skenën gjigante. Në skenë do t'i bashkohet këngëtarja St. Vincent për një performancë unike. Dua është nominuar për herë të parë në Grammy. Ajo mori dy nominime në kategorinë "Best New Artist" dhe në "Best Dance Recording". Në kategorinë e parë, Lipa përballet me Bebe Rexhën.

I rikthehet kanceri, nëna e Ronaldos 'lufton për jetën'

Mamaja e Cristiano Ronaldos ka zbuluar se po "lufton për jetën" pasi u diagnostikua me kancer. Dolores Aveiro mundi kancerin e gjirit pasi u diagnostikua me sëmundjen në vitin 2007, por kanceri i është rishfaqur. Në një intervistë për një stacion televiziv në Portugali, nëna e katër fëmijëve tha: "Jam operuar në njërin gji në Madrid, kam bërë kimioterapi dhe po luftoj për jetën".

Autor: GAZMEND MORINA

KËNGËTARJA E MADHE SHQIPTARE NË FOTO
E SHASTISUR; E HUTUAR
PIJE ALKOOLIKE, QË NXIRRET NGA MUSHTI I RRUSHIT
SHKRONJË GREKE
ANALISTI SHQIPTAR NAZARKO (shq.)
EPOKA E RE
SHKRONJA TË NJËJTA
DURRËSI
E MALLKOVA
TINARI
REPER I NJOHUR AMERIKAN (shq.)

SËMUNDJA E TUBERKULOZIT (pashq.)
ZAKONE / DRITËSHKURTËR (shq.)
MALLKIMI DHE PËRJASHTIMI NGA KISHA
MINDER I ULËT / NJËVJEÇARE
VEGËL DORE QË PËRBËHET NGA NJË KOKË METALI (shq.)
ZILI, INAT / SHKRIMTARI HAZIRI (shq.)
EMINE (perkdh.)
TOROLLAK / BASHKËT.
NJË NGJYRË
VEGËL BUJQËSORE / ALEANCË
ZANORE / SECILA NGA PJESËT QË FORMOJNË NJË TË TËRË
ECONOMIC TRANSFORM. PROGRAME
VARGU I PËRPUTHUR / POLITIKANI .... NDOKA
ERMELINDA MEKSI / DËSHMORI .... KODRA (UÇK)
KAFSHË E EGËR GJITARE (shq.)
AI QË E KISHTE DOBËSI THEMBRËN / ALEN NURI

EPOKA E RE
MASHTROJ ME DIÇKA TË PAQENË
RRALLËSIA (Lat.)
GODINË MBI LUMË (shq.)
FORMË E TË HYRAVE SHTETËRORE
TELEVIZION I YNI MUZIKOR NË RRJETIN KABLLOR
KASAFORTA / DAFINË
KËNGËTARE E NJOHUR ANGLEZE / AKTORJA CAHANI
ZBAVITËS, TËRHEQËS

I VRAZHDË, I ASHPËR
BEREQET
DERA E VOGËL E THURUR ME THUPRA / PORTIERI KASILLAS
GURRA / MJET PËR TRANSMETIMIN E VALËVE
QË ËSHTË LARA-LARA NË TRUP A NË FYTYRË, LARMI
DOKTOR (shk.) / BOTIM
KAJDET, OJNAT / MARC ANTHONY
QË KA TË BËJË ME ORATORINË
REGJISORI .... HALILI / I ZOTËROJ (bised.)
DY BASHKËTINGËLLORE / UGANDA, LIBERIA
RRIP I LLAMBËS
QYTET I SHENJTË I MYSLIMANËVE / PADASHUR (krah.)
FRIKA (bised.) / BELGJIKA, AUSTRIA
OSMAN TAFA
BASHKËT. / SHTET FEDERAL NË SHBA
FLOKU ARTIFICIAL / I GJALLË E I SHKATHËT; ENERGJIK
MJEDIS I TRUPIT / SHTERPE
BASHKËT. / PEZMATIM I VESHIT
NJËSIA MONETARE BAZË E JAPONISË (pashq.)
DENTAL ADMISSION TEST / "PANTER"
TONI ADAMS / LLOJ QELQI I PËRPUNUAR
KLUB FUTB. ARGJENTINAS ... LORENZO / KËNGËTARJA ... QAZIMI
OLIVER TUIST / DIJETAR FETAR MYSLIMAN

EPOKA E RE
QILIM PËR SHTROJË / PËRFAQËSUES I ZGJEDHUR NGA NJË ORGANIZATË
VLERË, DOBI (krah.)
TOP JASHTË LOJE (shq.) / TREVISO
KANAPE E GJERË DHE E GJATË SI SHTRAT (shq.)
DY BASHKËTINGËLLORE / GRYKË E VULLKANIT
AKTORI ... DAMON (shqip.) / AKTORI MORINA
AKTORJA E FAMSHME ... TYLER / FUTBOLLISTI FRANCEZ NASRI
ZANORE
GJENDJE E PA PUSHTET / KËNGËTARJA ..... DUSHKU
"R" pas dy "A" / DY ZANORE
PJESË E LOJËS NË TENIS / BREJTËS I VOGËL
KLUB I YNI FUTBOLLI
LEDINA (shk.)
AKTORI YNË ..... FERATI / SHENJA QË PËRFAQËSON NJË TINGULL MUZIKOR
KRYEHOXHË
BASHKËT. / LIGJI, KANUNI (vjet.)
HOVI, VRULLI
AMPER, TON, IRIDIUM / ELDER SCROLLS ONLINE
PORT DETAR (shq.) / METËR, NITON
GABRIEL IGLESIAS
POLITIKANI SHQIPTAR GAZMEND / ABEDIN REXHA
PËREMËR PRONOR / NOTË MUZIKORE
ZANORE / DY BASHKËTINGËLLORE
MOR, HEJ (pasth.) / ANA LUIS
QË ËSHTË LËNË I LIRË, PA FRE (vjet.)
ALBANOLOGU ..... RIZA / TOTENHAM
NDËRRIM I MALLIT (shq.) / INTER
KOS I RRAHUR E I PËRZIER ME HUDHRA
I PËRZEMËRT
VARIOLA

(Disa) ushqime dhe kanceri, kronologjia e një lidhjeje të dyshuar!

U deshën 50 vjet për të kuptuar se stilet e jetesës, në radhë të parë ajo që në pjatë, janë në origjinë të në shumë se gjysmës së tumoreve. Për të kujtuar rëndësinë e ndjekjes së një diete korrekte është Shoqata Italiane për Hulumtime të Kancerit (Airc), e cila është kthyer në 2,500 sheshe italiane me iniciativën 'Portokalli i Shëndetit'.

Të paktën 3 nga 10 raste të kancerit, për shkak të ushqimit

Ideja që ushqimi mund të ndikojë në shfaqjen e sëmundjeve nuk është e re: ajo është e pranishme në shumë mjekësi tradicionale, të

tilla si kineze ose indiane dhe në Perëndimin mesjetar - theksojnë ekspertët. - Hulumtimi i parë shkencor u pranua fillimisht me skepticizëm, por tashmë në fund të viteve '60 filluan studimet epidemiologjike që përfshinin një numër të madh njerëzish. U deshën vite për të marrë rezultate përfundimtare, arritën vetëm në kohët e fundit. Por sot e dimë se çfarë është më e mira për të ngrënë dhe çfarë duhet të shmanget".

1960: kancerogjene kimike të zbuluara në ushqim

Në gjysmë shekulli shkencëtarët në mbarë botën kanë përdorur në thelb dy instrumente: nga njëra anë, hulumtimet epidemiologjike, të cilat vlerësojnë mënyrën e jetesës dhe sëmundjet e mundshme të njerëzve, për të përcaktuar nëse ka marrëdhënie të rëndësishme mes zakoneve të caktuara (siç janë dieta dhe gjimnastika) dhe zhvillimit të tumorit; nga ana tjetër, hulumtimi molekular, i cili heton mekanizmat e ndërveprimit midis ushqimit dhe gjeneve, proteinave dhe komponentëve të tjerë të qelizave, për të kuptuar nëse disa substanca të pranishme në ushqim mund të promovojnë ose mbrojnë kundër fillimit të kancerit. Në vitin 1960, studimi i shkaqeve specifike të kancerit të lidhur me ushqimin filloi të prodhonte rezultate të rëndësishme. Identifikohen disa kancerogjene kimike, të përdorura në ushqime industriale, të cilat më pas ndalohen dhe eliminohen.

1967: jo vetëm ushqimi, por ndikon edhe stili i jetës

Në këtë vit, një studim tregon se emigrantët japonezë të transferuar në Shtetet e Bashkuara sëmuren, pas disa vitesh, me tumore të ngjashme me ato të amerikanëve: një konfirmim i rolit të stilit të jetesës në zhvillimin e tumoreve. Pastaj, në vitin 1969, onkologu Burkitt hipotizon që mungesa e fibrave në dietën perëndimore mund të kontribuojë

në zhvillimin e kancerit të zorrës së trashë, një nga më të drejtpërdrejtët të lidhur me dietën e varfër.

1973: Atlas gjeografik i rasteve të kancerit të zorrës së trashë

Agjencia Ndërkombëtare për Kërkimin e Kancerit (IARC) në Lyon shpërndan të dhënat e incidencës së kancerit sipas vendeve. Numrat dhe llojet ndryshojnë shumë: një tregues se shkaqet mund të lidhen me mjedisin dhe jetesën, si dhe me karakteristikat gjenetike të çdo popullate. Tani dihet se zgjedhja e ushqimit të shëndetshëm nuk është vetëm për yndyrë dhe kalori: duhet të shmangni majat e insulinës dhe gjendjet kronike inflamatore, të përgatitni një mburojë kundër radikalëve të lirë, të shkatërroni shpejt substancat toksike, për të forcuar sistemin imunitar, për të zvogëluar kaloritë, për të kontrolluar nivelet e hormoneve seksuale që qarkullojnë në trup dhe nuk e ushqejnë tumorin.

1975: zbulohet roli i ruajtjes së ushqimit dhe metodave të gatimit

Disa studime janë botuar mbi marrëdhëniet midis ruajtjes së ushqimeve të kripës, niveleve të ulëta të vitaminës C dhe kancerit të stomakut: sot ne e dimë se disa metoda gatimi dhe ruajtja e ushqimit mund të jenë të dëmshme.

1981: rezultatet e para mbi lidhjen mes ushqimit dhe kancerit

Dy epidemiologë britanikë, Richard Doll dhe Richard Peto, vlerësojnë se rreth 35 për qind e kancerit mund të parandalohet me një dietë të karakterizuar nga më pak yndyrë dhe mish dhe më shumë pemë dhe perime. Në vitin 1982 Akademia Kombëtare e Shkencave publikon në SHBA të parin raport mbi ushqimin dhe kancerin, i cili gjithashtu përfshin udhëzimet e para për ushqimin e duhur.

1990: Disa ushqime dhe alkooli i tepërt janë të dëmshme

Janë botuar shumë studime që konfirmojnë marrëdhëniet midis disa ushqimeve dhe kancerit dhe gjithashtu nxjerrin në pah lidhjet e tjera ndërmjet stilit të jetesës dhe tumorit. Lidhja midis konsumit të alkoolit dhe zhvillimit më të madh të tumoreve të zorrës së trashë dhe gjirit është gjithashtu e dukshme.

1994: dieta të ndryshme, veçanërisht të pasura me fruta dhe perime

Epidemiologu italian, Silvia Franceschi, vëren se për parandalimin e kancerit, një dietë e ndryshme është më e mirë se një dietë e shëndetshme, por shumë e kufizuar. Dhe në vitin 1996 epidemiologët Steinmetz dhe Potter tregojnë se dietat e pasura me perime dhe fruta (duke përfshirë fibrat, antioksidantët dhe mikroorganizmat e tjerë) zvogëlojnë rrezikun për t'u sëmurur. Sot nuk ka më asnjë dyshim: të paktën 3 raste të kancerit në 10 janë për shkak të asaj që hamë. Është po aq e sigurt se dieta mesdhetare luan një rol mbrojtës: shumë studime tregojnë se një dietë me kalori, e pasur me yndyra shtazore, mish të kuq, salsiçe dhe fibra të ulët shoqërohet me një rritje të tumoreve. Nga ana tjetër, dietat e pasura me fibra (që karakterizohen nga një konsum i lartë i frutave dhe perimeve) duket se kanë një rol mbrojtës.

2004-2014: të dhënat epike të studimit: Dieta mesdhetare dhe kile shtesë

Studimi epidemiologjik mbi zakonet e jetës së europianëve, bashkëfinancuar nga AIRC. Rezultatet tregojnë se dieta mesdhetare është modeli më efektiv i ushqimit në parandalimin e kancerit. Në 2012-2013, analiza e mëtejshme e të dhënave EPIC tregon se konsumi i flavonoideve (antioksidantë që përmbahen në shumë ushqime me origjinë bimore) zvogëlon rrezikun e kancerit të stomakut. Konfirmohet gjithashtu rreziku i lidhur me konsumimin e mishit të përpunuar. Në vitin 2014, EPIC arrin informacione të tjera, që tregon se obeziteti përbën një faktor rreziku për shumë lloje të tumoreve, veçanërisht nëse rritet periferia e barkut.

Gazeta Shqip

Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE	FULHAM - MANCHESTER UNITED	2-2	FIORENTINA - NAPOLI	GG	MONCHENGLADBACH - HERTHA	1

Ferizaj dhe Feronikeli në kërkim të gjysmëfinales

Sot zhvillohet ndeshja e parë në kuadër të çerekfinales së Kupës. Takohen Ferizaj dhe Feronikeli. "Ne i kemi fituar dy ndeshje, por kundërshtarët kanë qenë të rangut më të ulët. Tash e kemi ndeshjen me Feronikelin, që është një skuadër me lojtarë shumë cilësorë dhe lufton për titull dhe Kupë, por nuk i frikësohemi. Jemi të vetëdijshëm se do të jetë ndeshje shumë e vështirë, por ne luajmë në fushën tonë dhe do të hyjmë në këtë ndeshje për fitore. Shpresojmë të kualifikohemi në gjysmëfinale të Kupës, pse jo edhe në finale", ka thënë Dautaj

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 8 SHKURT - KF Ferizaj është në pjesën të tabelës në IPKO Superligën e Kosovës në futboll, por në garën e Kupës ka synime të mëdha edhe përkundër faktit se kundërshtare e ka skuadrën e Feronikelit. Qëndrim Dautaj ka thënë të hënën për "Epokën e re" se skuadra nga Drenasi ka potencial të madh, por Ferizaj nuk është dorëzuar dhe kërkon kualifikimin në gjysmëfinale. Ndeshja në mes të Ferizajt dhe Feronikelit zhvillohet sot, kurse tri ndeshjet e tjera zhvillohen të dielën. "Ne i kemi fituar dy ndeshje, por kundërshtarët kanë qenë të rangut më të ulët. Tash e kemi ndeshjen me Feronikelin, që është një skuadër me lojtarë shumë cilësorë dhe lufton për titull dhe Kupë, por nuk i frikësohemi. Jemi të vetëdijshëm se do të jetë ndeshje shumë e vështirë, por ne luajmë në fushën tonë dhe do të hyjmë në këtë ndeshje për fitore. Shpresojmë të kualifikohemi në gjysmëfinale të Kupës, pse jo edhe në finale", ka thënë Dautaj, i cili në të kaluarën ka mbrojtur ngjyrat e "Niklit".

Synime të mëdha ka edhe skuadra e Feronikelit për ndeshjen që zhvillohet sot (e shtunë) në Ferizaj. Sulmuesi Kastriot Rexha për gazetë ka konfirmuar se skuadra e drejtuar nga Zekrija Ramadani kërkon fitoren ndaj Ferizajt, pasi synim e ka triumfin në garën e Kupës. "Në Ferizaj do të jetë ndeshje e rëndësishme për ne pasi synojmë ta ndjekim edhe Kupën. Shpresojmë të kalojmë këtë ndeshje. Kjo është ndeshja e parë për sezonin pranveror. Nëse e nisim me sukses, mund të jetë e rëndësishme edhe për ndeshjet e radhës në kampionat", ka thënë Rexha. Feronikeli, krahas synimeve të mëdha në garën e Kupës, është duke luftuar edhe për titull të kampionit së bashku me Prishtinën dhe Llapin.

ÇEREKFINALJA E KUPËS

Të shtunën takohen:
13:00 Ferizaj - Feronikeli
Të dielën takohen:
13:00 Vëllaznimi - Drita
13:00 Kika - Ballkani
15:00 Prishtina - Trepça '89

Gashi: Përkrahja për federatat është rritur 100 %

"Duke pasur parasysh se sportistët kosovarë i kanë sjellë rreth 100 medalje gjatë vitit 2018 dhe duke e konsideruar këtë sukses të madh sportiv, kemi vendosur që buxhetin për federatat dhe për sportistët ta rrisim për 100 %", ka thënë ministri Kujtim Gashi

PRISHTINË, 8 SHKURT - Në bazë të rregulloreve 04/2018 për kategorizimin e sporteve dhe asaj 05/2018 për kategorizimin e sportistëve dhe trajnerëve, ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka nënshkruar vendimet të cilat caktojnë vlerën financiare të pikëve. Nëpërmjet dy vendimeve ministri ka caktuar vlerën financiare për poentimin e pikëve për sportet kolektive dhe individuale.

Poentimi për sportet kolektive dhe individuale bëhet në katër grupe: A, B, C dhe D. Grupi A ndahet në: Federatat të cilat merren me sportet kolektive kanë vlerën e pikëve 3 400 euro; Federatat të cilat merren me sportet individuale kanë vlerën e pikëve 2 000 euro. Ndërkaq për grupin B vlera e pikës është 1 600 euro. Për grupin C vlera e pikës është 1 200 euro. Dhe për grupin D vlera e pikës është 800 euro. Ndërsa për vlera financiare e poentimit të pikëve për sportistët dhe trajnerët është caktuar

në vlerë prej 150 eurosh për pikë për të dyja kategoritë. Ministri shpjegoi se këto vlera si për sportet, po ashtu edhe për sportistët dhe trajnerët, bën të mundur qysh në fillim se sa do të paguajë MKRS-ja këto kategori, ngaqë përmes këtyre akteve nënligjore, kush punon më shumë, me meritë përkrahet më shumë financiarisht. "Të gjitha këto rritje që kanë ndodhur të cilat janë paraparë për vitin 2019, për mbështetje të federatave, sportistëve, trajnerëve, edhe sportet kolektive dhe ato individuale kanë një objektiv të vetëm që Kosova të jetë sa më e pranishme në garat ndërkombëtare, të sjellin sa më shumë medalje e çmime dhe, po ashtu, të ketë një mbështetje të fuqishme që të gjithë sportistët tanë të përgatiten edhe për lojërat olimpike Tokio 2020", ka deklaruar Gashi.

Ai shtoi se Ministria që udhëheq ai është e interesuar për përmirësimin e cilësisë së sportit në përgjithësi dhe kjo rrugë e përkrahjes financiare është një nxitje për sportistët, trajnerët si dhe federatat që të punojnë edhe më shumë si në prezantim të suksesshëm në gara vendore dhe ndërkombëtare si dhe për korrjen e rezultateve. "Duke pasur parasysh se sportistët kosovarë i kanë sjellë rreth 100 medalje gjatë viti 2018 dhe duke e konsideruar këtë sukses të madh sportiv, ne kemi vendosur që buxhetin për federatat dhe për sportistët ta rrisim për 100 %", ka thënë ministri Gashi.

Rikthehet hendbolli

PRISHTINË, 8 SHKURT - Me ndeshjet e javës së 15-të fillon stinori pranveror në Superligën e Kosovës në hendboll (meshkujt). Pritet të jetë garë e fortë për titull të kampionit, por edhe për t'i siguruar pozitat që sigurojnë daljen në gara evropiane e, po ashtu, për ta evituar largimin nga elita. Të shtunën janë dy ndeshje, që nisin në ora 19:00, kurse tri ndeshjet e tjera luhen të dielën.

Kampioni në fuqi, Besa Famgas, e pret Dritën e Gjilanit. Besa në pjesën e parë të kampionatit i ka fituar 13 ndeshje, kurse e ka humbur vetëm një. I ka 26 pikë, sa edhe Kastrioti i Ferizajt. Drita është e katërta me 20 pikë. Ndeshja e dytë e së shtunës është ajo mes Drenicës e Trepçës që luhet, po ashtu, nga ora 19:00, në Drenas. Është kjo një përballje me peshë e skuadrave të pjesës së poshtme të tabelës. Tri ndeshje të tjera të javës së 15 pra janë të dielën. Nga ora 16:00 në Gjilan takohen Zhegra e Prishtina, kurse nga ora 17:00 luajnë Vëllaznimi e Samadrexha si dhe Vushtrria e Kastrioti. Prishtina me 24 pikë po e mban hapin në garë me dy të parët në tabelë. Zhegra është në vend të shtatë me 7 pikë.

Kosova, gati për Festivalin Olimpik Evropian

PRISHTINË, 8 SHKURT - Komiteti Olimpik i Kosovës ka prezantuar të premten Ekipin Olimpik të Kosovës para nisjes për në Festivalin Olimpik Evropian Dimëror për të Rinj (EYOF) "Sarajeva 2019". "EYOF 2019" mbahet prej 10-16 shkurt në Sarajevë dhe Sarajevën Lindore të Bosnjë e Hercegovinës. Kosova përfaqësohet me skitaret Klea Vrella dhe Elba Kokaj, të cilat do të garojnë në disiplinat sllallom dhe sllallom të madh. Për KOK-un, pjesëmarrja në EYOF-i dimëror 2019 është e dyta pas debutimit në "Erzurum 2017". Në delegacionin e Kosovës për në EYOF "Sarajeva 2019", përveç dy skitareve Elba Kokaj dhe Klea Vrella, janë edhe Besim Hasani, Shasivar Haxhijaj, Jeton Rudari, Kushtrim Krasniqi, Feim Kollqaku, Egzon Agani, Selim Maloku.

Akili, Nora e Distria synojnë 'pushtimin' e podiumit në Paris

Prishtinë, 8 shkurt - Akil Gjakova, Nora Gjakova e Distria Krasniqi synojnë ta "pushtojnë" podiumin e Grand Slamit në Paris 2019. Sot (e shtunë) dhe nesër (e diel) mbahet ky Grand Slam, kurse ekipi i Kosovës përfaqësohet me tre garues. Akil Gjakova do të rikthehet në garën ku e nisi suksesin vitin e kaluar. Ai kishte fituar medaljen e artë në kategorinë e tij, deri në 73 kilogramë. Kampionia e Evropës, Nora Gjakova, garon në kategorinë deri në 57 kilogramë, ndërsa nënkampionia e Evropës në kategorinë -52 kilogramë, kurse Distria Krasniqi garon në -48 kg. Gara e Grand Slamit vlerësohet një prej më të fortave në xhudo, ndërsa është e vlefshme edhe për pikë olimpike për Lojërat Olimpike "Tokyo 2020". Të tre xhudistët tanë garojnë të shtunën.

Derbi zhvillohet në kryeqytet

Prishtinë, 8 shkurt - Ponte Prizreni - Golden Eagle Ylli është dueli me të cilin nis xhiroja e XVIII në Superligën e Kosovës në basketboll, i cili do të zhvillohet të shtunën me fillim nga ora 17:00 në palestrën "Sezai Surroi" në Prizren. Po të shtunën në program është një tjetër ndeshje, ajo në mes të Z Mobile Prishtinës dhe Bashkimit që do të luhet duke filluar nga ora 19:00 në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë. Të dielën do të zhvillohet një tjetër ndeshje interesante, ajo në Mitrovicë në mes të Trepçës dhe Rahovecit, me fillim nga ora 17:00, në palestrën "Minatori", kurse Lipjani është nikoqir i AFK Boreas, takim ky që luhet duke filluar nga ora 19:00. Pas 17 xhirove të luajtura në elitën e basketbollit kosovar, Z Mobile Prishtina kryeson në renditjen tabelore me 34 pikë, e ndjekur nga Golden Eagle Ylli dhe Rahoveci që kanë tubuar secila nga 28 pikë dhe Ponte Prizreni që është në vendin e katërt me 25 pikë, aq sa ka edhe Trepça dhe Bashkimi që ndodhen në pozitën e pestë, respektivisht të gjashtë.

FBK-ja shton edhe ndeshjen për vendin e tretë në "Final 8"

Bordi i FBK-së ka aprovuar idenë dhe kërkesën e KB Rahoveci që në kuadër të Euroing Kupës së Kosovës të shtohet edhe ndeshja për vendin e tretë, përkatësisht për medaljen e bronztë. Në këtë ndeshje ballafaqohen dy skuadrat gjysmëfinaliste që nuk arrijnë të plasohen në finale. Ndeshja në orar është zyrtarizuar për të shtunën, më 2 mars, në orën 19:00. Duhet të theksohet se kjo është hera e parë që një ndeshje për vend të tretë zhvillohet në kuadër të Kupës së Kosovës në basketboll.

Lakersat e mposhtin Bostonin në sekondën e fundit

Boston, 8 shkurt - Një kosh në sekondën e fundit nga ana e Rajon Rondos i dha fitoren skuadrës së Lakersit, që mposhti 129-128 Bostonin në fushën e këtij të fundit. Një takim mjaft emocionues dhe dramatik në fundin e tij, pasi të dyja ekipet dueluan fort për fitoren, duke dhuruar spektakël në fushë. Për Bostonin, Irvingu realizoi 24 pikë, ndërkohë që 63 pikë u realizuan nga lojtarët e stolit, por që nuk mjaftuan për ta shmangur humbjen. Për Lakersin u dallua LeBron Jamesi me 28 pikë, mbështetur nga Kuzma me 25, ndërkohë që shtatë lojtarë të ekipit kalifornian realizuan mbi 10 pikë.

Skuadra e Torontos vijon të shkëlqejë në Lindje, duke mposhtur edhe Atlantan me rezultatin 119-101. Ndeshje me dy pamje, më e mirë për Atlantën në të parën, ndërsa në të dytën janë kanadezët ata që dominojnë dhe fitojnë falë 33 pikëve e 14 reboundeve të Siakamit si dhe 30 pikëve të VanVleetit. Zhgënjen skuadra e San Antonios, që u mund 127-118 nga Portlandi, sfidë e dominuar nga Blazersi. McCollum realizoi 30 pikë, mbështetur edhe nga Lillarsi me 24 pikë e Nurkiqi me 22. Nuk dështon skuadra e Oklahomës, që mundi 117-95 Memphisin, ndeshje e dominuar nga basketbollistët e Thunderit. Paul George realizoi 27 pikë, ndërsa Granti 20. Vijon të mos i ndahet "triple double" Russell Westbrook, që e mbylli ndeshjen me 15 pikë, 13 rebounde dhe 15 asistime. Humbet Clippersi, që u ndal 116-92 nga Indiana (Bogdanoviq 29 pikë).

REZULTATET

Indiana - Clippers	116-92
Orlando - Minnesota	122-112
Atlanta - Toronto	101-119
Boston - Lakers	128-129
Oklahoma - Memphis	117-95
Portland - San Antonio	127-118

SHKURT

Barça katër muaj pa Arthurin

Barcelona ka konfirmuar se mesfushori Arthur Melo do t'i mungojë skuadrës deri në katër javë shkaku i lëndimit. Përfaqësuesi i Brazilit lëndoi tejzën e gjurit në derbin ndaj Real Madridit në mesjavë në kuadër të Kupës së Mbretit. 27-vjeçari pritet të mungojë në ndeshjet ndaj Athletico Bilbaos, Real Valladolidit dhe Sevillës në La Liga, si dhe në ndeshjen e parë ndaj Lyonit në kuadër të Ligës së Kampionëve, si dhe ndeshjen kthyese në gjysmëfinalen e Kupës së Mbretit ndaj Realit.

Sarri: City, ekipi më i mirë në Evropë

Premierë Liga rezervon të dielën një nga ndeshjet më të bukura të saj, me Manchester Cityn që pret Chelsean. Vendësit kërkojnë fitoren për ta vazhduar garën me Liverpoolin dhe Tottenhamin për titullin, ndërsa "Blutë e Londrës" kërkojnë pikë për Ligën e Kampionëve. "Në ndeshjen e fazës së parë ishim me fat. Siti dominoi në pjesën e parë dhe ne shënuam në momentin tonë më të vështirë. Në pjesën e dytë luajtëm më mirë dhe në fund nuk vodhëm asgjë. Ndeshja e radhës do të jetë shumë e vështirë, sepse Siti është ekipi më i mirë në Evropë dhe luan të njëjtin futboll prej tre vjetësh", ka thënë Maurizo Sarri, trajner i Chelseat.

Dele Alli kthehet në mars

Dele Alli ka bërë hapa të mëdhenj drejt shërimit të lëndimit të kofshës dhe rikthimit në fushën e futbollit. Së bashku me Harry Kanen, janë dy futbollistët që po i mungojnë Tottenhamit në këtë fazë, kur është rritur intensiteti i ndeshjeve. Alli u lëndua muajin e kaluar dhe po stërvitet ngadalë në Dubai, por nuk do të mund të jetë i gatshëm për ekipin deri në fillim të muajit mars, shkruajnë mediet në Angli.

Milani shet Kessien për Bakayokon

Milan po mendon ta gjejë formulën për të blerë përfundimisht nga Chelsea kartonin e Tiemoue Bakayoko, i cili është kthyer në lojtarin më solid në mesfushën e kuqezinjve. Milan po përgatitet ta blejë përfundimisht 24-vjeçarin nga Chelsea, por afrimi i Paqueta dhe Piatek nuk ua jep luksin të shpenzojnë edhe 40 milionë euro të tjera në verë, prandaj Milani po mendon ta nxjerrë në shitje Franck Kessien.

Solskjaeri e kërkon Chiesan në United

Federico Chiesa vazhdon ta habisë dhe ta ngjallë interesin e shumë skuadrave të madhe evropiane. Sipas medieve angleze, radhës së gjatë të ekipeve që interesohen për talentin e Fiorentinës i shtohet edhe Manchester Unitedi, pasi trajneri Ole Gunnar Solskjaer e pëlqen shumë futbollistin. Për të arritur te kartoni i 21-vjeçarit "Djajtë e Kuq" më parë duhet ta mposhtin konkurrencën e Bayern Munchenit, Juventusit, Interit dhe Napolit që kanë kohë që janë vënë në ndjekje të sulmuesit, kartoni i të cilit nga klubi vjollcë vlerësohet rreth 60 milionë euro.

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria –Vlada-Government
Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës
Univerziteska Bolnička i Klinička Služba Kosova- Hospital and Univesity Clinical Service of Kosovo
Spitali i Përgjithshëm –Opsta Bolnica –Genel Hastane "Prim.Dr.Daut Mustafa" Prizren

Nr./br./nr. 814
Më/dana/tarih: 08.02.2019
P r i z r e n

Bazuar në nenin 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 i Punës, Udhëzimin Administrativ (MPMS)Nr. 07/2017 Për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Nenit 62, pika 6 të Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi, kërkesës nga drejtori i përgjithshëm i SHSKUK-së më datën 06.02.2019, si dhe nenit 13, pika 1.1 të Statutit të Spitalit, Këshilli Drejtues i Spitalit të Përgjithshëm shpall:

KONKURS

Dëshiron të pranojë në punë në kohë të pacaktuar / želi da primi na posao na neodredjeno vreme / Süresiz çalışan aranıyor
Titulli i pozitës / Naziv polozaja / Pozisyonun başlığı:
Mjekë specialistë-/Lekara specialista/ Doktorlar uzmanları:

1.	Mjekë Specialistë	Kërkuar
2.	Mjekë Specialist i biokimisë	1
3.	Mjekë Specialist dermatolog	2
4.	Mjekë Specialist kardiolog	2
5.	Mjekë Specialist kirurg maksillofacial	3
6.	Mjekë Specialist kirurg vaskular	1
7.	Mjekë Specialist ortoped	1
8.	Mjekë Specialist psikiatër i fëmijëve	1
9.	Mjekë Specialist radiolog	1

- Koeficienti i pagës: (8.4)
- Norma e punës: Orar i plotë (40 orë në javë)
- Kontrata Sipas legjislacionit në fuqi
- Kualifikimi i kërkuar për mjekë specialistë / Kvalifikacija koja se zahteva za spec.lekara / Doktorlar uzmanları için gerekli yeterlilik: Fakulteti i Mjekësisë, specializimi në fushën përkatëse/ Medicinski Fakultet, Specializacija na relavantan oblast/ Tıp Fakültesi, ilgili alanda uzmanlık.
- Aftësitë, përvoja dhe atributet tjera që kërkohen / Veštine, iskustvo i druge osobine koje se zahtevaju. / Beceriler, deneyim ve gerekli diğer özellikler: Të ketë aftësi organizative në profesion/Da ima sposbnost organizacije na radu / Mesleğinde örgütsel becerilere sahip olmak. Të njohë së paku një gjuhë vendore dhe është e dëshirueshme njohja e gjuhës angleze dhe puna me kompjuter/Znati najmanje jedan lokalni jezik i poželjno je znanje engleskog jezika i rad na kompijuteru / En az bir yerel dili tanımak ve İngilizce bilmek ve bilgisayarlarla çalışmak arzu edilir.
- **Dokumentat e kërkuara / Trazena dokumentacija / Gerekli belgeler:**

1. Diploma e Fakultetit të Mjekësisë / Diploma medicinskog fakulteta/ Tıp Fakültesi Diploması
2. Licenca e punës nga Ministria e Shëndetësisë nga lëmia përkatëse / Licenca rada od Ministrarstvo Zdravja relavantan oblast / Çalışma Ruhsatı İlgili alanda Sağlık Bakanlığı tarafından
3. Certifikatën e lindjes / izvod rodjenih / Doğum belgesi;
4. Certifikatën që nuk jeni i dënuar dhe nën hetime / Izvod da niste osudjeni ili pod istragom / Hükümlü ve soruşturma altında olmadığınızı gösteren belge;

Procedurat e konkurrimit/Procedure konkurisanja/Rekabet Prosedürleri: Konkurrimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar/Konkurs je otvoren za sve zainteresovane kandidate/Yarışma ilgilenen tüm adaylara açıktır
Konkursi është i shpallur 15 ditë / Konkurs je otvaran 15 dana/ Konkurun açılış ve kapanış tarihi: prej/od 08.02.2019 deri/do 22.02.2019.
Në testim do të ftohen vetëm kandidatët që kanë plotësuar kriteret e konkursit. Kandidatët që i plotësojnë kriteret e konkursit do t'i nënshtrohen testit me shkrim. Të gjithë kandidatët të cilët nuk e kalojnë testin me shkrim mbi 50% do të diskualifikohen automatikisht. Ndërsa, të gjithë kandidatët që ju kanë nënshtruar testit me shkrim, dhe kanë arritur të kalojnë atë 50% e më shumë të pikëve të tij, do të ftohen në intervistën me gojë, pranë komisionit intervistues. Renditja e kandidatëve do të bëhet sipas pikëve të përgjithshme që do të fitojë çdo kandidatë nga dy proceset si më sipër (testimi me shkrim dhe intervista me gojë).
Samo kandidati koji su ispunili kriterijume konkursa će biti pozvani na test. Kandidati koji ispunjavaju kriterijume konkurisanja biće pozvani na pismeni test. Svi kandidati koji ne polože pismeni test preko 50% biće automatski diskvalifikovani. Dok će svi kandidati koji su podnijeli pismeni test i uspjeli da ga polože 50% i više bodova, biti će pozvani na razgovor sa komisijom za intervjue. Rangiranje kandidata će se zasnivati na ukupnom broju bodova koji će se osvojiti svaki kandidat iz dva gore navedena procesa (pismeno testiranje i usmeni intervju).
Teste yalnızca rekabet kriterlerini karşılayan adaylar davet edilecektir. Yarışma kriterlerini karşılayan adaylar yazılı bir sınava tabi tutulur. Yazılı sınavı geçemeyen bütün adaylar% 50'yi geçemezse otomatik olarak diskalifiye edilirler. Yazılı bir sınavda bulunan ve puanlarının% 50'sini ve daha fazlasını geçmeyi başaran tüm adaylar görüşme komitesi ile görüşmeye davet edilecektir. Adayların sıralaması kazanılacak toplam puanlara göre belirlenir.Yukarıdaki iki süreçten her aday (yazılı sınav ve sözlü mülakatlar).
Paraqitja e kërkesave/ Podnošenje prijave/ Uygulamaları gönderme: Aplikacionet merren dhe dorëzohen në administratë. Në aplikacion duhet të ceket qartë titulli i vendit të punës dhe numri i referencës/ Aplikacije se primaju i podnose u upravi. U prijavi treba jasno navesti naziv posla i referentni broj/. Başvuru, iş unvanını ve referans numarasını açıkça belirtmelidir.
- Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen / Aplikacije primljene nakon zatvaranja konkursa nece biti prihvacene. Nekompletirane aplikacije mogu biti odbijene / Son tarihten sonra gönderilen talepler kabul edilmeyecektir. Eksik başvurular reddedilebilir.
- Emri, mbiemri dhe numri i telefonit të personit i cili mund të kontaktohet në rast të ndonjë pyetjeje/Ime, prezime i broj telefona osobe koju treba kontaktirati u slucaju bilo kakvih pitanja/Herhangi bir sorunuz olursa, irtibat kurulabilecek kişinin adı, soyadı ve telefon numarası

Drejtori i Administratës
Ujesa i Juridikut, Mëmnda Çollaku

Republika e Kosovës
Republika Kosova-RepublicofKosovo
Qeveria –Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES DHE TEKNOLOGJIS
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr:33/1
Dt: 08.02.2019

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032,Neni 4, Ligjit të Punës nr03/L-212, Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Neni13 dhe 34, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012(Neni4),Udhëzimit Administrativ Nr. 10/2018,Udhëzimit Administrativ 05/2015, Udhëzimit Administrativ 07/2017 si dhe në bazë të kërkesave të shkollave, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të lira në Sh. M. M "Shtjefen Gjeqovi", në Prishtinë për vitin shkollor 2018/2019

Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita/Vend i ilirë	Vendi lirë/ Zëvendësim
Sh. M. M	"Shtjefen Gjeqovi"	Prishtinë	Një (1) mësimdhënës/e për lëndën Gjuhë angleze me 14 orë Një (1) mësimdhënës/e për lëndën profesionale të tekstilit , praktik profesionale 12 orë, Konstruktim dhe modelim 9 orë	Zëvendësim deri në kthimin e mësimdhënies Zëvendësim deri në kthimin nga pushimi i lehonisë
			Një (1) mësimdhënës/e për lëndën e Psikologjis me 13 orë dhe 6 orë estetikë; Një (1) mësimdhënës/e për lëndën Teknologjisë Informative 14 orë mësimore; Një (1) mësimdhënës/e për lëndën e Matematikes me 14 orë mësimore;	Vend i lirë Vend i lirë Vend i lirë

Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës të nivelit të IV-të;

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë plan programin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e plan programit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të sillet me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin ne fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrën Kompetencës dhe AAAPARr-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Diagnostikon kushtet për mësim dhe proceseve mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrën e duhur ndaj tyre,duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për mësimdhënës:

- Fakulteti adekuat;
- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvojës punës në arsim;
- Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet përgatitja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën trysni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;
- Në mungesë të kandidatëve të kualifikuar pranohen dhe kandidatët me kualifikime të përafërt në afat të caktuar;
- Në kushtet të barabarta, përparësi do të kenë kandidatët të cilët janë duke punuar në të njëjtin vend të punës.

Procedurat e konkurrimit:

Afati i konkurrimit është 15ditë pas shpalljes. Aplikacionet dhe dokumentet e kërkuara duhet të merren dhe dorëzohen në administratën e institucioneve në të cilat është shpallur konkursi gjegjësisht në Sh. M. L.P "Shtjefën Gjeçovi", në Prishtinë .
Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin (për të diplomuarit jashtë vendit dëshmitë e nostrifikimit të diplomës), dëshmia për përvojën e punës, dëshmia që nuk janë nën hetime dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës.
Kërkesat e arritura pas mbylljes së konkursit, dhe aplikacionet e pa kompletuara nuk shqyrtohen. Kandidatët të cilët do të ftohen në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale.
Në mungesë të kandidatëve me kualifikim adekuat në intervistë thirren edhe kandidatët me kualifikim të përafërt, në të kundërtën intervistohen vetëm kandidatët me kualifikim përkatës.



AUTOSHKOLLA
"RITMO – L"



Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë

Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.

Ju mirëpret:
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "
Tel / kontakt:
044 248 173
044 200 604
044 375 333

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and Industry

Në pajtim me dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 03/ L -149, Rregullore Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovë, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë shpallë:

REKRUTIM

Institucioni: Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Inspektorati i tregut
Titulli i vendit të punës: **Inspektor i tregut**
Koeficienti / 7
Nr. i Referencës: MTI/ 1
Numri i zyrtarëve që do të pranohen: 1
Vendi: Prishtinë **Data: 8.2.2019**

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Zhvillon dhe arrin pëlqimin për planet e punës dhe afatet, në koordinim me mbikëqyrësin, për zbatimin e projekteve, shërbimeve dhe produkteve përkatëse në fushën profesionale specifike;
- Kryen detyra e parapara në planet e punës të miratuara në përputhje me ligjet, rregulloret, politikat dhe procedurat përkatëse, brenda afateve kohore të caktuara, fushën e konsumit të përgjithshëm të tregut për mbikëqyrjen e tregtimit dhe qarkullimit të mallrave dhe shërbimeve në treg;
- Bën hulumtime, analiza, dhe përcakton objektivat që dalin nga përparësitë e inspektimit nga vlerësimi i rrezikut që paraqitet në treg dhe jep rekomandime për shqyrtim nga nivelet e larta;
- Ushtron kontrollë-inspektim tek operatorët ekonomik (personat fizikë dhe juridikë) në tërë territorin e Republikës së Kosovës;
- Ofron këshilla në fushën e ekspertizës të kërkuar brenda institucionit;
- Koordinon punën me pjesët tjera të institucionit dhe komunikon, sipas nevojës, me autoritetet e jashtme;
- Kryen çdo detyrë tjetër në fushën profesionale specifike në përputhje me ligjet dhe rregulloret aktuale të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe.

Kualifikimet për këtë vend të punës:

- Diplomë universitare: Juridik, Ekonomik;
- Minimum 3 vite përvojë pune profesionale;
- Njohuri të thella dhe të specializuar në fushën profesionale specifike të fituar përmes arsimimit universitar dhe trajnimeve përkatëse;
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel,Power Point, Access);

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:
Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës , të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë shkollimin e lartë dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave.
Kohëzgjatja e emërimit:
Nëpunësi i karrierës (përhershëm) Periudha provuese .Dymbëdhjetë (12) muaj.
Data e mbylljes së konkursit:
22.2.2019
Paraqitja e kërkesave
Formularët për aplikim mund të merren në recepcion të MTI-së, ose të tërhiqen nga *web* faqja e MTI-së, ku është bërë edhe shpallja e konkursit , në adresën **www.mti-ks.org** dhe dorëzohen në Divizionin e Burimeve Njerëzore, çdo ditë pune nga ora 8:00 -16:00 deri më: **22.2.2019.** Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr. tel. 038-200 36-578.
"Shërbimi Civil i Republikës së Kosovës, ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë".
"Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcionalë organet e shërbimit civil të administratës publike,qendrore dhe lokale,siç specifikohet në Nenin 11, paragrafi 3të Ligjit Nr..03/L-149 mbi shërbimin Civil të Republikës së Kosovës"
Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen.
Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuara,vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and Industry

U skladu sa odredbama Zakona o Civilnoj Službi Republike Kosovo, Zakon Br. 03/L -149, Pravilnik Br. 02/2010 o Procedurama Regrutacije u Civilnoj Službi Republike Kosova, Ministarstvo Trgovine i Industrije objavljuje:

REGRUTOVANJE

Institucija: Ministarstvo Trgovine i Industrije
Tržišna Inspektorat
Naziv radnog mesta: **Tržišni inspektor**
Koeficijent / 7
Referentni br: MTI/ 1
Broj zvanićnika koji će biti prihvaćeni: 1
Mesto: Priština **Datum: 8.2.2019**

Obaveze i odgovornosti:

- Razvija i postiže saglasnost za radne planove i rokove, u koordinaciji sa nadzornikom, za implementaciju relevantnih projekata, usluga i proizvoda u specifičnom stručnom oblasti;
- Izvršava obaveze predvidene planovima rada usvojenim u skladu sa dotičnim zakonima, propisima, politikama i procedurama, u određenim vremenskim rokovima, u oblasti opšte tržišne potrošnje za nadzor nad tržištem i kretanjem roba i usluga na tržištu;
- Sprovodi istraživanja, analize i definiše objektive koji proizilaze iz prioriteta inspekcije i procene rizika koji se pojavljuje na tržištu i daje preporuke za razmatranje od strane viših nivoa;
- Vrši kontrolu-inspekciju ekonomskih operatera (fizičkih i pravnih lica) na celoj teritoriji Republike Kosovo;
- Pruža savete u oblasti ekpertize zahtevani unutar institucije;
- Koordinira rad sa drugim delovima institucije i komunicira, po potrebi, sa vanjskim vlastima;
- Obavlja i sve druge obaveze u specifičnoj profesionalnoj oblasti u skladu sa važećim zakonima i propisima, koje se razumno mogu povremeno zahtevati.

Kvalifikacije za ovo radno mesto:

- Univerzitetska Diploma: Pravni, Ekonomski Fakultet;
- Minimum 3 godine radnog iskustva u struci;
- Duboko i specijalizovano znanje u specifičnom stručnom polju stečeno kroz visoko obrazovanje i odgovarajuću obuku;
- Poznavanje primenljivih zakona i propisa;
- Veštine u komunikaciji, planiranju i vođenju tima;
- Istraživačke, analitičke i ocenjivačke veštine i formulisanje stručnih preporuka i saveta;
- Kompjuterske veštine u softverskim aplikacijama (Word, Excel,Power Point, Access);

Uslovi učešća u regrutovanju:
Pravo apliciranja imaju svi punoletni građani Republike Kosovo koji imaju punu poslovnu sposobnost, imaju visoku školsku spremu i stručnu sposobnost za obavljanje obaveza.
Trajanje imenovanja:
Službenik karijere (stalni). Probni period dvanaest (12) meseci.
Datum zatvaranja konkursa:
22.2.2019
Podnošenje prijave
Formulari za prijavu se mogu dobiti na recepciji MTI, ili vebsajtu MTI, gde je i objavljen konkurs, u www.mti-ks.org adresu i dostavljaju se Diviziji za Ljudske Resurse, svaki radni dan od 8:00 -16:00, do:22.2.2019. Za sve dodatne informacije možete kontaktirati br. tel. 038-200 36-578.
"Civilna Služba Republike Kosovo, pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Kosova i pozdravlja aplikacije svih osoba muškog i ženskog pola svih zajednica na Kosovu."
"Manjinske zajednice i njihovi pripadnici imaju pravo na pravično i proporcionalno zastupljenost organi civilne službe javne, centralne i lokalne administracije, kao što je navedeno u Članu 11, stav 3 Zakona Br.03 / L-149 o Civilnoj Službi Republike Kosovo"
Zahtevi pristigli nakon određenog roka neće biti prihvaćeni.

Zbog velikog broja primljenih zahteva, samo uži izbor kandidata će biti kontaktirani.

Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"- Prishtinë
Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë

NJOFTIM

Njoftojmë të interesuarit se me datën 21 shkurt 2019 (E enjte) me fillim në orën 11:00, Bsc. i dipl. Elbasan H. Çekaj mbron punimin e Masterit me titull "Hulumtimi i vetive agrobiologjike të kultivarëve të boronicës amerikane (Vaccinium Corymbosum)". Mbrojtja publike do të jetë në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë në Prishtinë.
Mentor: Dr.sc. Vahid Avdiu. Prof.ass
Anëtar të Komisionit janë:
1. Prof. Aso.dr. Bedri Dragusha - kryetar
2. Prof.dr. Shukri Fetahu - anëtar
3. Prof. Ass.dr. Xhavit Ramadani - anëtar

Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"- Prishtinë
Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë

NJOFTIM

Njoftojmë të interesuarit se me datën 21 shkurt 2019 (e enjte) me fillim në orën 12:00 Bsc. i dipl. Fatlum S. Mehmeti mbron punimin e Masterit me titull "Potenciali prodhues gjenetik i populacionit Somborka në lokacionin e Obiliqit". Mbrojtja publike do të jetë në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë në Prishtinë.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Naser Derguti shpall te pavlefshme certifikatën e trajnimit bazik për zjarrfikës dhe shpëtim me datë 21.11-10.12.2007, me nr serik 733.

▶ Sabajdin Berisha, shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Zekeria Rexha" në Gjakovë.

▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

▶ Shitet banesa në Lakërishte përballë Procredit Bankës, hyrja e parë kati i 9 banesa ka 50m2 me dokumentacion të rregullt, çmimi52 000€. Për info 044/672-439.

▶ Lëshohet me qira banesa në lakërishte afër Procredit bankës është e mobiluar 50m2 për një çift çmimi është 220€. Për irno 044/672-439.

▶ Shes banesën hyrja e 7 mbi kurriz te banesat e gjelbërta përball shkollës "Xhemajl Mustafa" e rinovuar tërësisht. Banesa ka 82 metra katror. 3 dhoma, sallon, shpajz dhe ballkon + taras me shfrytëzim. Çmimi 75000 Euro me para te gatshme, por bej edhe ndërrim me banesë me të vogël në Prishtinë ose banesë më të madhe në Fushë Kosovë sipas marrëveshjes. Numri kontaktues: 044 672 439

▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

▶ Kërkoj kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.

▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

▶ Lëshohet banesa me qira kati i parë , në rr. Esat Mekuli, çmimi i volitshëm. Për info. 044/ 477-107 Prishtinë. Çmimi shumë i volitshëm dhe është e mobiluar komplet.

▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.]

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

MEKA
HALAL FOOD
pashtetë pule
gluten free
100% mish pule
cilësi e garantuar
pa konservues

ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1905
0.5L